

ÇËSHTJA ËSHTË BE-JA, JO ANËTARËSIMI I BALLKANIT PERËNDIMOR...

OPINIONI PUBLIK FRANCEZ MBI
ANËTARËSIMIN E BALLKANIT
PERËNDIMOR NË BE

Autorë:

Christine Hübner

Jan Eichhorn

Luuk Molthof

d|part – Grup ekspertësh
mbi pjesëmarrjen politike

OPEN SOCIETY
EUROPEAN POLICY
INSTITUTE

d|part

Srđan Cvijić

Open Society
European Policy Institute

FALENDERIM

Dëshirojmë të falenderojmë Hedvig Morvai, Jasna Jelisić, Pierre Mirel, Sébastien Gricourt, Florent Marciacq, Loïc Tregoures, Anouar El-Anouni, Ivan Vejvoda, Vedran Dzihic dhe Teresa Reiter për këshillat e tyre shumë të vlefshme për ndërtimin e metodologjisë së këtij studimi, si dhe Fondacionin Erste për kontributin e tyre në këtë studim.

OPEN SOCIETY FOUNDATIONS

© 2021 Open Society Foundations



Përkthim në gjuhën shqipe i kryer nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Ky botim është në dispozicion si PDF në faqen e internetit të Projektit nën një licencë 'Creative Commons' që lejon kopjimin dhe shpërndarjen e botimit, vetëm në tërësinë e tij, për sa kohë që i atribuohet Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur dhe d/parit dhe përdoret për qëllime jokomerciale arsimore ose të politikave publike. Fotografitë nuk mund të përdoren veçmas nga botimi.

opensocietyfoundations.org

PËRMBAJTJA

2	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE
4	HYRJA
7	1. SHUMICA E NJERËZVE NË FRANCË KUNDËRSHTOJNË ZGJERIMIN E BE-SË NË BALLKANIN PERËNDIMOR, POR PËR ATA KJO NUK ËSHTË NJË ÇËSHTJE E SPIKATUR
12	2. QËNDRIMET MBI ZGJERIMIN E BE-SË NË BALLKANIN PERËNDIMOR PASQYROJNË MË TEPËR PIKËPAMJET E PËRGJITHSHME MBI BE-NË SESA SHQETËSIME APO NJOHURI SPECIFIKE
20	3. PRANUESIT DHE KUNDËRSHTUESIT KANË SHQETËSIME TË NJËJTA PËRSA I PËRKET ZGJERIMIT TË BE-SË NË BALLKANIN PERËNDIMOR, POR TRAJTIMIN E TYRE E SHOHIN NË MËNYRA TË NDRYSHME
26	4. KOMUNIKIMI PIKË SË PARI DUHET TË TRAJTOJË SHQETËSIMET NË LIDHJE ME BE-NË NË PËRGJITHËSI
29	PËRFUNDIME
32	SHTOJCA

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Franca është një nga vendet evropiane me shkallën më të lartë të kundërshtimit popullor ndaj zgjerimit të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor. Po ku mbështetet ky kundërshtim, dhe sa e rëndësishme është çështja e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor për Francën? Ky raport, i cili përdor një kombinim të paraqitjes së të dhënave të studimit të vitit 2020 me popullsinë e rritur franceze dhe me fokus-grupe të thelluara votuesish francezë, ofron një panoramë gjithëpërfshirëse mbi këndvështrimin e francezëve nëse vendet e Ballkanit Perëndimor duhet t'i bashkohen BE-së apo jo. Rezultatet janë të rëndësishme për vendimmarrësit politikë si dhe aktorët e shoqërisë civile. Përfundimet tona më të rëndësishme janë:

1. Shumica e njerëzve në Francë kundërshtojnë bashkimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor me BE-në, por për shumicën e tyre kjo çështje nuk është një çështje e spikatur dhe qëndrimet nuk janë shumë të ngurta.

Me afro 60% kundërshtim, shumica e të intervistuarve thanë se do të ishte disi keq ose shumë keq, nëse Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia do t'i bashkoheshin BE-së. Megjithatë, më pak sesa një e treta thanë se zgjerimi i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor do të prekte jetët e tyre shumë ose të paktën disi, dhe pothuajse gjysma ndryshuan këndvështrim mbi çështjen, në varësi të faktit nëse u pyetën rreth rajonit në përgjithësi apo për shtete specifike. Kjo tregon që për shumicën e njerëzve në Francë, zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor nuk është çështje e spikatur dhe pikëpamjet mbi këtë temë nuk janë shumë të ngurta.

2. Qëndrimet mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor pasqyrojnë më tepër pikëpamjet e përgjithshme mbi BE-në, sesa stereotipet ose shqetësimet specifike ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Midis të intervistuarve në sondazh, ata që kundërshtonin bashkimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor me BE-në, ishin të prirur të kishin pikëpamje shumë më negative për vetë BE-në, sesa ata që e miratuan zgjerimin e BE-së në rajon. Një në dy 'kundërshtues' kanë një imazh tepër ose shumë negativ për BE-në. Në dallim me këta, afro dy të tretat e 'miratuesve' thanë se kanë një imazh mjaft ose shumë pozitiv për BE-në. Kjo të shtyn drejt përfundimit se për shumë njerëz në Francë, mendimi nëse Ballkani Perëndimor do t'i bashkohej BE-së, pasqyron pikëpamjet mbi BE-në në përgjithësi.

3. 'Pranuesit' dhe 'kundërshtuesit' kanë shqetësime të njëjta për sa i përket zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, por arrijnë në përfundime të ndryshme mbi aftësinë e BE-së për tu marrë me këto çështje.

Në thelb, ata që janë pro bashkimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor me BE-në, besonin se BE-ja mund të përballlet me sfidat që sjell zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht sfidat ekonomike, ndërsa ata kundër ishin më pak optimistë. Gjetjet më tej mbështesin përfundimin se pikëpamjet mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor janë pasqyrim i pikëpamjeve që njerëzit kanë mbi BE-në, kapacitetin e saj për të integruar shtete të reja anëtare dhe pasojat që këto do të sjellin për Francën.

4. Qeveria franceze duhet të jetë e vetëdijshme se për shumicën e qytetarëve, zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor nuk është një çështje e spikatur.

Nisur nga rëndësia e pakët e kësaj çështjeje mes votuesve francezë, ka pak gjasa që vazhdimësia e procesit të zgjerimit në Ballkanin Perëndimor të ketë një ndikim domethënës në politikën e brendshme franceze në përgjithësi dhe në procesin zgjedhor në veçanti. Frika se qeveria franceze mund të ndëshkohet nga elektorati për shtyrjen përpara të procesit të zgjerimit, nuk gjejnë bazë në këtë studim. Kjo nuk do të thotë se politikë-bërësit nuk duhet të jenë të kujdesshëm për mundësinë që njerëzit të ndihen sikur u është hequr e drejta për të vendosur mbi këtë çështje. Për shumë njerëz në Francë, zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor shoqërohet me shqetësime mbi kohezionin evropian, ndjenjat e mosbesimit brenda në BE si dhe mungesën e kontrollit.

5. Komunikimi mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor duhet të ofrojë siguri për ata me shqetësime të pashprehura si edhe të trajtojë shqetësimet e përgjithshme të votuesve francezë në lidhje me BE-në.

Nëse nuk trajtohen më parë shqetësimet më të përgjithshme që kanë njerëzit në lidhje me kohezionin evropian dhe të ardhmen e BE-së, zgjerimi i mëtejshëm i BE-së mund të shtojë një tjetër shtresë pakënaqësie në Francë ndaj sjelljeve të BE-së. Në planin afatgjatë, mënyra më e mirë për të ecur përpara është të krijohet një besim më i madh tek BE-ja, institucionet, rregullat e procedurat e saj, dhe të sigurohet që komunikimi mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor të mos nxisë pikëpamje negative mbi kohezionin evropian mes votuesve francezë. Kur është fjala për Ballkanin Perëndimor, argumentat abstrakte nuk kanë gjasa të ndikojnë në pikëpamjet e njerëzve, ndërsa përmirësimi i përvojave personale (siç janë mundësitë për turizëm) kanë potenciale pozitive.

HYRJA

Tetori 2019 ishte vendosur të ishte hapi i radhës për zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kishin shpresuar të përparonin në nivelin tjetër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian pas samitit të 17 tetorit. Por Franca dhe Holanda vunë veton mbi fazën tjetër të bisedimeve me Shqipërinë, dhe Franca vuri veton edhe mbi përparimin e Maqedonisë së Veriut.¹ Pasojat kanë qenë të mëdha, me diskutime jo vetëm në lidhje me të ardhmen e këtyre dy vendeve, por edhe të zgjerimit të BE-së në përgjithësi.² Pasi Komisioni Evropian propozoi ndryshime të rregullave të procesit³, në mars 2020, dy shtetet anëtare në përfundim ndryshuan qëndrimin e tyre⁴. Megjithatë,

kundërshtimi i tyre fillestar dhe i fortë la shenja afatgjata në debatin mbi zgjerimin e BE-së.

Qeveria franceze luajti një rol veçanërisht të rëndësishëm në këtë dështim. Megjithëse Presidenti francez Emanuel Makron ka qenë për një kohë të gjatë përkrahës i rritjes së integritimit evropian, ai ka shprehur shpesh shqetësim në lidhje me zgjerimin e mëtejshëm.⁵ Ai do të garojë për tu rizgjedhur në vitin 2022, dhe mbështetësit e tij kanë deklaruar se këndvështrimi i Makronit pasqyrore pikëpamjet e një pjese të madhe të popullit francez. Në sondazh, një shumicë e dukshme e popullsisë së rritur franceze u deklaruan kundër futjes së vendeve të tjera në

-
- 1 Nielsen, N. (2019). 'BE nuk mban premtimin për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.' EU Observer, 18 tetor 2019. Gjetet tek <https://euobserver.com/enlargement/146329>.
 - 2 Cvijic, S. & Cerimagic, A. (2020). 'Rindërtojme Shtëpinë e Letrave: Me më shumë ngjitës'. Institute for Democracy: Societas Civilis Policy Paper No. 52. Skopje: Institute for Democracy: Societas Civilis. Gjetet tek https://idsocs.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/9_A5_REBUILDING-OUR-HOUSE-OF-CARDS_WITH-MORE-GLUEENG.pdf.
European Stability Initiative (2020). 'Besueshmëria e miut në rrotë dhe politika e BE-së për Ballkanin'. ESI Report, 15 janar 2020. Gjetet tek <https://www.esiweb.org/sites/default/files/reports/pdf/ESI%20-%20Hamster%20in%20the%20Wheel%20-%2015%20January%202020.pdf>.
 - Delevic, M. & Prelec, T. (2019). 'Më të sheshta e të shpejta: Rrugët e reja të Ballkanit Perëndimor për në BE.' Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë, 24 tetor 2019. Gjetet tek https://www.ecfr.eu/article/commentary_flatter_and_faster_new_western_balkans_pathways_to_the_eu.
 - Cvijic, S., Kirova, I., Kirchner, M.J., & Nechev, Z. (2019). Nga Zgjerimi në Unifikimin e Evropës: Pse Bashkimi Evropian ka nevojë për një drejtori të përgjithshme Evrope për anëtarët e ardhshëm dhe vendet e asociimit', Bruksel: Shoqëria e Hapur, Instituti për Politikën Evropiane. Gjetet tek https://www.opensocietyfoundations.org/publications/from-enlargement-to-the-unification-of-europe#publications_download.
 - 3 Maksimov, V. (2020). 'Komisioni përpiqet t'i japë frymë të re zgjerimit të BE-së.' EURACTIV, 5 shkurt 2020. Gjetet tek <https://www.euractiv.com/section/all/news/commission-tries-to-breathe-new-life-into-eu-enlargement/>.
 - 4 Maksimov, V. (2020). 'BE lëviz për të filluar bisedimet e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë.' EURACTIV, 23 mars 2020. Gjetet tek <https://www.euractiv.com/section/enlargement/news/eu-moves-to-start-membership-talks-with-north-macedonia-albania/>.
 - 5 Tcherneva, V. & Varma, T. (2019). 'Pas vetos franceze: Përleshja e re për Ballkanin Perëndimor.' Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë, 25 tetor 2019. Gjetet tek https://www.ecfr.eu/article/commentary_after_the_french_veto_the_new_scramble_for_the_western_balkans.

Bashkimin Evropian. Në Eurobarometrin e vitit 2019, për shembull, vetëm 1/3 e të anketuarve francezë (32%) e pranonin zgjerimin në parim, ndërsa 58% u shprehën kundër tij.⁶ Për më tepër, publiku francez u duk se ishte kundër zgjerimit të BE-së specifikisht në Ballkanin Perëndimor. Një sondazh i kryer në dhjetor 2018 zbuloi kundërshti të madhe ndaj anëtarësimit të Shqipërisë dhe Kosovës në BE (me 56% kundërshtarë), dhe ndaj vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor u shfaq një kundërshtim vetëm pak më i vogël (52% kundër anëtarësimit të Serbisë dhe Bosnje-Hercegovinës, dhe 44 e 43% përkatësisht ndaj Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi).⁷

Kur është fjala tek zgjerimi i BE-së, Franca nuk është vendi i vetëm me një publik skeptik, por është një prej vendeve me përqindjen më të lartë të popullsisë kundër zgjerimit. Vetëm Holanda ia kalon në përqindjen e kundërshtarëve të zgjerimit (60%), megjithëse kundërshtia është e lartë edhe në Gjermani (57%), Austri (57%) dhe Belgjikë (56%). Megjithatë, në krahasim me këto vende, kundërshtimi i francezëve ndaj anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE është i shprehur në mënyrë më të theksuar.⁸

Pra, a pasqyroi pikëpamjen e shumicës së popullit francez kundërshtimi i qeverisë franceze ndaj anëtarësimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor? Me fjalë të tjera, a ishte veprim i matur nga pikëpamja zgjedhore?

Megjithëse anketimet e nivelit të lartë mund të duket se e mbështesin këtë këndvështrim, arritja e një përfundimi të qartë është më e vështirë. Kur njerëzit i përgjigjen një pyetjeje në një anketim, përgjigjet e tyre duhen kuptuar sikur ata ndajnë të njëjtat pikëpamje mbi atë çështje kur pyeten për të. Megjithatë, kjo nuk është njësoj si të vlerësosh sa rëndësi ka për njerëzit një çështje dhe, sidomos, sa ndikon ajo në vendimet e tyre në votim. Kjo do të

Pra, a pasqyroi pikëpamjen e shumicës së popullit francez kundërshtimi i qeverisë franceze ndaj anëtarësimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor? Me fjalë të tjera, a ishte veprim i matur nga pikëpamja zgjedhore?

thotë se të dhënat ekzistuese të sondazhit nuk japin mundësi të trajtohet pyetja e rëndësishme se sa e spikatur apo e rëndësishme është çështja e zgjerimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor për francezët, dhe sa lidhje kanë pikëpamjet mbi këtë çështje me vendimet politike

Të paktën tre pyetje në lidhje me qëndrimin e francezëve ndaj zgjerimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor mbeten pa përgjigje.

1. Së pari, edhe pse në sondazhe një shumicë e publikut francez shpreh kundërshti ndaj anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, ne nuk e dimë se sa e rëndësishme është çështja në të vërtetë. Sondazhet rrallë vlerësojnë nëse zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor është një temë për të cilën njerëzit mendojnë shpesh dhe nëse e konsiderojnë apo jo diçka që mund të ndikojë ndjeshëm në jetën e tyre. Megjithatë, pa e ditur se sa e spikatur është çështja, ne nuk mund të gjykojmë në çfarë mase qëndrimet ndaj saj ndikojnë në të vërtetë në sjelljen e votuesve.
2. Së dyti, sondazhet ekzistuese nuk na lejojnë të arrijmë në përfundimin nëse pikëpamjet mbi anëtarësimin në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor janë specifike për vlerësimin e këtyre vendeve, apo pasqyrojnë çështje të tjera, më të

6 Komisioni Evropian. (2019) 'Eurobarometri standard 91. Pikëpamjet e evropianëve mbi përparësitë e Bashkimit Evropian. Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim. Gjetet tek <https://ec.europa.eu/comfrontoffice/publicopinion/index.cfm/Survey/getSurveyDetail/instruments/STANDARD/surveyKy/2253>.

7 YouGov (2018). 'Rezultatet e sondazhit YouGov/Eurotrack'. YouGov. Gjetet tek https://d25d2506sfb94s.cloudfront.net/cumulus_uploads/document/ofavfkfy8j/YouGov%20Eurotrack%20EU%20membership%202.pdf

8 Smith, M. (2019). 'Eurotrack: Cilat vende mendojnë evropianët se duhet të jenë në BE?' YouGov, 5 mars 2019. Gjetet tek: <https://yougov.co.uk/topics/international/articles-reports/2019/03/05/eurotrack-it-was-mistake-admit-romania-and-bulgari>

përgjithshme në lidhje me zgjerimin e BE-së. Teksa francezët janë kundërshtues në përgjithësi, kundërshtimi i tyre ndaj anëtarësimit të shumicës së vendeve të Ballkanit Perëndimor është disi më i ulët se kundërshtimi i tyre për zgjerimin e BE-së në vetvete. Deri në çfarë mase vlerësimet e këtyre vendeve kanë të bëjnë me pikëpamjet mbi BE-në dhe mbi zgjerimin e BE-së në mënyrë më të përgjithshme?

3. Së treti, ne nuk e dimë deri në çfarë mase pikëpamjet mbi anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor bazohen në stereotipe, njohuri të mira mbi rajonin, apo njohuri mbi procedurat e zgjerimit të BE-së.

Ky raport i trajton këto çështje. Ai jep një informacion më të thelluar mbi pikëpamjet e francezëve përse i përket anëtarësimit, apo jo, të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Duke përdorur një kombinim të të dhënave të reja nga anketime të popullsisë së rritur franceze dhe fokus-grupeve të thelluara me votues francezë⁹, ne identifikojmë qëndrime të ndryshme dhe me nuanca, si dhe profile të spikatura, si dhe shqyrtojmë çfarë i karakterizon dhe i nxit qëndrimet ndaj Ballkanit Perëndimor dhe zgjerimit të BE-së në Francë. Në raport përmbledhen gjetjet kryesore të anketimit dhe të hulumtimit mbi fokus-grupin. Aty jepet një tablo e re dhe e hollësishme mbi ato çfarë publiku francez mendon mbi Ballkanin Perëndimor dhe të ardhmen e Bashkimit Evropian, si dhe jepen rekomandime të qarta mbi komunikimin në lidhje me këtë çështje.

9 N=2,025 të rritur francezë, të moshës 18 vjeç e lart, përfaqësues të popullsisë së rritur franceze sipas gjinisë, moshës, rajonit dhe nivelit të shkollimit, të anketuar në mars 2020. Fokus grupe me gjithsej 28 pjesëmarrës të rekrutuar për të përfaqësuar pikëpamje të ndryshme mbi zgjerimin e BE-së, në Lion në shtator 2020. Të gjithë emrat e dhënë në këtë raport janë pseudonime që pasqyrojnë gjininë e pjesëmarrësve. Shih shtojcën për më shumë hollësi mbi metodat.

1. SHUMICA E NJERËZVE NË FRANCË KUNDËRSHTOJNË ZGJERIMIN E BE-SË NË BALLKANIN PERËNDIMOR, POR PËR ATA KJO NUK ËSHTË NJË ÇËSHTJE E SPIKATUR


Edhe pse shumica e të anketuarve në Francë thonë se janë kundër anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, për shumicën e të anketuarve kjo nuk është një çështje e spikatur apo me interes dhe qëndrimet nuk duket të jenë fort të ngurta.

Duke bashkuar qëndrimet dhe rëndësinë që i jepet pyetjes nëse vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të anëtarësohen në BE, ne mund të dallojmë disa profile të qarta mes publikut francez.

FIGURA 1

Qëndrimet ndaj anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE¹⁰

Qëndrimi ndaj anëtarësimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia (në %), N=2,025 të anketuar



10 Formulimi i pyetjes: "A mendoni se do të ishte mirë apo keq, nëse do të shihnim zgjerimin e BE me/ anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë që bashkohen/ në Bashkimin Evropian?" Ju lutemi vini re se çdo formulim pyetjeje ("zgjerimi me" ose "anëtarësimi i") është përdorur rastësisht për gjysmën e të gjithë të anketuarve përkatësisht, për të kontrolluar ndjeshmërinë ndaj formulimit të pyetjes. Rezultatet nuk ishin statistikisht të ndryshme për secilin grup, kështu që të gjitha përgjigjet analizohen së bashku.


Për të matur pikëpamjet e publikut francez mbi anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, ne i pyetëm të anketuarit dhe pjesëmarrësit e grupeve të fokusit mbi pikëpamjet e tyre për këtë çështje dhe sa e rëndësishme/e spikatur ishte kjo çështje për ta personalisht. Rezultatet mbi pyetjen e parë konfirmojnë gjetjet nga sondazhet e mëparshme (Figura 1). Me gati 60% kundërshtim, shumica e të anketuarve thanë se do të ishte disi keq (33%) ose shumë keq (26%) nëse vendet si Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia bashkohen me BE-në. Nga ana tjetër, 22% e njerëzve e konsideruan këtë diçka shumë ose disi të mirë, dhe 19% thanë se nuk dinin si ta vlerësonin pyetjen.

Shkalla e kundërshtimit për vendet e Ballkanit Perëndimor veç e veç varion shumë, midis 49 dhe 65%, dhe shumë më e lartë se për Norvegjinë dhe Islandën, por gjithsesi më e ulët se për Turqinë (Figura 2). Afërsisht gjysma e të anketuarve deklarojnë se janë kundër anëtarësimin të Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut në BE (49%, dhe përkatësisht 27% dhe 25% që e miratojnë). Deri në 60% deklarojnë kundërshtimin e tyre ndaj anëtarësimin të Bosnjë-Hercegovinës, Serbisë, dhe Shqipërisë (përkundër miratimit të rreth 20%) dhe deri në 65% janë kundër anëtarësimin të Kosovës në BE (me vetëm 15% pro).

FIGURA 2

Qëndrimet ndaj anëtarësimin në BE të vendeve individuale të Ballkanit Perëndimor¹¹

Mendimet mbi anëtarësimin e këtyre vendeve në BE në të ardhmen, krahasimisht (në %), N=2,025 të anketuar



11 Formulimi i pyetjes: "Për secilin nga vendet e paraqitura më poshtë, ju lutemi tregoni në çfarë mase mendoni se do të ishte një gjë e mirë apo e keqe në përgjithësi, nëse ata hyjnë në Bashkimin Evropian në të ardhmen."

Të pyetur në lidhje me ndikimin personal të një pranimi të mundshëm të Turqisë, 53% e të anketuarve francezë - gati 2 herë më shumë sesa për të njëjtën pyetje për Ballkanin Perëndimor - thanë se një vendim mbi këtë çështje do të ndikonte në jetën e tyre.


Sidoqoftë, pyetja e dytë, në lidhje me rëndësinë e çështjes, zbulon se një shumicë e të anketuarve francezë nuk kanë ndjenja të forta për zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor. Më pak se 1/3 (28%) thanë se shtimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE do të ndikonte shumë ose të paktën disi në jetët e tyre (Figura 3). Shumica e të anketuarve mendonin

se kjo pjesë e politikës së BE-së nuk do të ndikonte shumë, ose aspak në jetën e tyre (53%) dhe 19% tjerë nuk kishin asnjë mendim në lidhje me rëndësinë e çështjes.

Ky interesim i pakët mbi këtë çështje është veçanërisht i habitshëm kur krahasojmë pikëpamjet e të anketuarve në lidhje me pranimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor me pikëpamjet e tyre mbi pranimin e Turqisë (Figura 3). Të pyetur në lidhje me ndikimin personal të një pranimi të mundshëm të Turqisë, 53% e të anketuarve francezë - gati dy herë më shumë sesa për të njëjtën pyetje mbi Ballkanin Perëndimor - thanë se një vendim mbi këtë çështje do të ndikonte në jetën e tyre. Për më tepër, përqindja e të anketuarve që thonë se anëtarësimi i Turqisë do të "ndikojë shumë në jetën e tyre" (30%) është më shumë se trefishi i atyre që thonë të njëjtën gjë për vendet e Ballkanit Perëndimor (8%).

FIGURA 3

Rëndësia që ka çështja e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor përkundrejt asaj të Turqisë¹²



12 Formulimi i pyetjes: "Në çfarë mase mendoni se do të ndikonte në jetën tuaj pranimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor / Turqisë në Bashkimin Evropian?"

Ne gjithashtu mësuam se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve francezë nuk duket se kanë pikëpamje shumë të ngurta mbi çështjen e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Pothuajse gjysma e të anketuarve (43%) ndryshuan pikëpamjet e tyre në lidhje me çështjen nga fillimi deri në fund të sondazhit, duke dhënë një përgjigje ndryshe për pyetjen në lidhje me pikëpamjet e tyre mbi anëtarësimin e të gjithë rajonit në BE krahasuar me atë për pyetjen mbi vende specifike të rajonit.¹³ Madje 9% i ndryshuan përgjigjet nga “mirë” në “keq” e anasjelltas. Kjo përshtypje u konfirmua edhe tek grupet e fokusit, ku një sërë pjesëmarrësish pranuan se nuk kishin opinione të ngurta mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor. Disa të tjerë thanë se pyetja ishte e vështirë dhe nuk dinin çfarë të mendonin për të.

Të marra së bashku, spikatja apo rëndësia e ulët në përgjithësi e çështjes, e kombinuar me treguesit se një pjesë e mirë e të anketuarve nuk duket se kanë pikëpamje të prera për këtë sugjeron se, për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë franceze, çështja e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE nuk ka rëndësi të madhe. Qëndrimet e tyre rrallë janë të ngulitura thellë dhe nuk ka gjasa që çështja të ndikojë fuqishëm në votimin e publikut dhe vlerësimet e politikave - të paktën jo për pjesën e madhe të popullsisë për të cilën çështja ka një spikatje/rëndësi të ulët.

Për të kuptuar si nuancat në pikëpamjet e njerëzve për çështjen e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, ashtu edhe ndryshimet në pikëpamjet e gjetura në të gjithë Francën, diskutimet për këtë çështje duhet të kalojnë binaret e thjeshta të pranimit-kundërshtimit. Vlerësimet e opinionit publik francez duhet gjithashtu të bëjnë dallimin

Për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë franceze, çështja e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE nuk ka rëndësi të madhe. Qëndrimet e tyre rrallë janë të ngulitura thellë dhe nuk ka gjasa që çështja të ndikojë fuqishëm në votimin e publikut dhe vlerësimet e politikave.

midis atyre që e konsiderojnë çështjen me shumë rëndësi/interes dhe presin që ajo personalisht të ndikojë tek ata, dhe atyre që nuk e konsiderojnë të tillë.

Kombinimi i qëndrimeve dhe rëndësisë së çështjes zbulon të paktën pesë grupe të veçanta njerëzish, të cilët të gjithë kanë mendime të ndryshme në lidhje me çështjen nëse vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të hyjnë në BE (Tabela 1):

- Një grup i konsiderueshëm njerëzish (22% e të gjithë kampionit) të cilët janë kundër anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE dhe për të cilët kjo përbën një çështje të spikatur, d.m.th. një shqetësim të fortë (**kundërshtues të interesuar**).
- Një grup shumë i vogël njerëzish (4% e të gjithë kampionit) që kanë qëndrime pozitive ndaj anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE dhe që mendojnë se do të sjellë një ndryshim të madh në jetën e tyre, dmth për të cilët është një çështje e spikatur (**miratues të interesuar**).

13 Dy pyetjet ishin: (1) “Disa njerëz mendojnë se anëtarësimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE do të ishte një gjë e mirë, ndërsa të tjerë mendojnë se do të ishte një gjë e keqe. Cila nga të mëposhtmet është më afër pikëpamjes tuaj?” dhe (2) “A mendoni se në përgjithësi do të ishte mirë apo keq, nëse do të shihnim zgjerimin e BE me / pranimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia të anëtarësohen / hyjnë në Bashkimin Evropian?”

- Shumica e njerëzve (54% e të gjithë kampionit) për të cilët çështja e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në përgjithësi është me një spikatje të ulët. Edhe pse këta njerëz nuk kanë mendime të prera në lidhje me këtë çështje, ata shprehin qëndrime kur pyeten. Ky grup përfshin gjithashtu të anketuar që shprehën një qëndrim por thanë se nuk janë të sigurt se sa e rëndësishme është çështja për ta.¹⁴
- Nga këta të anketuar të cilët janë pak të interesuar për çështjen, 18% në parim janë pro anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE (**pranues pak të interesuar**), ndërsa 36% tregojnë ca shqetësim (**kundërshtues pak të interesuar**).
- Një grup njerëzish (19% i të gjithë kampionit) të cilët janë të **pasigurt** ose nuk kanë asnjë mendim në lidhje me çështjen e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.

TABELA 1

Profilët e qëndrimeve dhe interesit për zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor

		QËNDRIMET NDAJ ANËTARËSIMIT TË VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË BE		
		SHUMË/DISI MIRË	SHUMË/DISI KEQ	NUK E DI
Interesimi mbi anëtarësimin e Ballkanit Perëndimor në BE	Do ndikonte disi/ shumë në jetë	4% (Miratim – interesim i madh)	22% (Kundërshtim – interesim i madh)	19% (Të pasigurt)
	Nuk do ndikonte shumë / aspak / Nuk e di	18% (Miratim – Interesim i pakët)	36% (Kundërshtim – Interesim i pakët)	

Për të llogaritur si nuancat në mendimet e njerëzve për çështjen e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE ashtu edhe ndryshimet në mendimet e gjetura në të gjithë Francën, në pjesën tjetër të këtij raporti ne i ndajmë të anketuarit dhe pjesëmarrësit e grupeve të fokusit bazuar në qëndrimet e tyre për çështjen, si dhe në sa me interes ishte kjo çështje për ta. Ne karakterizojmë grupet e mëposhtme, secili përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të popullsisë franceze, në përputhje me qëndrimin e tyre dhe rëndësinë e perceptuar nëse vendet në Ballkanin Perëndimor duhet të anëtarësohen në BE apo jo:


- Kundërshtuesit me interes të madh** (22% e të gjithë kampionit);
- Kundërshtuesit me interes të pakët** (36% e të gjithë kampionit);
- Miratuesit** (22% e të gjithë kampionit, pavarësisht interesimit, duke kombinuar miratuesit me interes të madh e të pakët)
- Një grup pjesëmarrësish **të pasigurt**, (19% e të gjithë kampionit).

14 Ne ose mund ta trajtojmë këtë si një përgjigje "Nuk e di" - ndaj spikatjes së çështjes, ose mund ta konsiderojmë si një shprehje të spikatjes së ulët në përgjithësi. Kjo e fundit duket se është e justifikuar: nëse një person thotë "Nuk e di", ata nuk mendojnë se çështja është e rëndësishme, ose nuk duan të merren shumë me të.

2. QËNDRIMET MBI ZGJERIMIN E BE-SË NË BALLKANIN PERËNDIMOR PASQYROJNË MË TEPËR PIKËPAMJET E PËRGJITHSHME MBI BE-NË SESA SHQETËSIME APO NJOHURI SPECIFIKE

Në Francë, qëndrimet ndaj çështjes nëse vendet e Ballkanit Perëndimor duhet ose nuk duhet të hyjnë në BE janë më të lidhura me qëndrimet e përgjithshme të njerëzve ndaj BE-së dhe ndjesisë së të qenurit të përfaqësuar nga politikanët e zgjedhur. Për shumicën e pjesëmarrësve në studim, qëndrimi i tyre në lidhje me këtë çështje nuk ishte aq i lidhur me nivelin e tyre të njohurive në lidhje me vendet e Ballkanit Perëndimor që mund të anëtarësohen në BE, përvojat specifike me këto vende apo stereotipet e tyre. Në fakt, pikëpamjet në lidhje me zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor ishin të lidhura më ngushtë me vlerësime më të përgjithshme të gjendjes së BE-së, të ardhmen e saj, zgjerimin e BE-së në përgjithësi, si dhe me sa mirë përfaqësohej Franca në BE sipas mendimit të tyre.

Mes të anketuarve të sondazhit, ata që nuk pranonin anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE ishin të prirur të kishin një pamje shumë më negative për BE-në sesa ata që pranonin zgjerimin e BE-së në rajon. Një në dy kundërshtues kishte një imazh disi ose shumë negativ të BE-së (55% mes atyre për të cilët çështja kishte shumë spikatje/rëndësi, dhe 41% mes kundërshtuesve me interes të pakët, Figura 4). Nga ana tjetër, afër dy të tretat e miratuesve - pavarësisht se sa interes kishin për çështjen - thanë se ata kishin një imazh shumë ose mjaft pozitiv të BE-së (midis 62 dhe 64%), krahasuar me vetëm një të katërtën e kundërshtuesve (24 dhe 27%, në varësi të interesimit për çështjen).

FIGURA 4**Imazhi i Bashkimit Evropian, sipas qëndrimeve ndaj zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor**

Më konkretisht, ata që nuk e pranonin zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor, dhe në një farë mase ata që nuk ishin të sigurt për mendimin e tyre mbi këtë çështje, kishin shumë më shumë gjasa të thoshin se integrimi evropian kishte shkuar tepër larg, në krahasim me ata që ishin pro (56%, krahasuar me vetëm 11% mes pranuesve). Ky mendim se integrimi evropian kishte shkuar tepër larg u shpreh qartë nga kundërshtuesit në grupet e fokusit. Për shumicën e tyre, pikëpamjet bazoheshin në perceptimin se kishte probleme serioze me kohezionin dhe bashkëpunimin midis vendeve aktuale anëtare të BE-së.

Kriza aktuale shëndetësore e shkaktuar nga COVID-19, si dhe krizat e mëparshme të borxheve evropiane, dhe pasojat politike në lidhje me migracionin, i

nxorën në pah këto probleme. Pjesëmarrësit në fokus-grupe ku u bënë bashkë kundërshtues të zgjerimit të BE-së përsëritën argumentet e përdorura nga Emanuel Makron në një fjalim në një takim të Ballkanit Perëndimor në 2018¹⁵: : ata ishin të mendimit se BE-ja duhet të zgjidhte së pari krizat dhe problemet e fundit brenda grupit aktual të vendeve anëtare, përpara se të fuste vende të tjera në bashkim.

“Mendoj se e kemi të vështirë të ndërtojmë unitet në Evropë. Pra, nëse do të kishite shtete të reja, mendoj se do t'i bënte gjërat edhe më të vështira. (...) Mendoj se për momentin ne duhet të harmonizohemi dhe unifikohemi përpara se të pranojmë shtete të reja.”
— Madeleine, 29, kundërshtuese me interes të madh

15 Radosavljevic, Z. & Morgan, S. (2018). 'Informacion – Makron tërheq qilimin e Ballkanit.' *EURACTIV*, 25 prill 2018. Gjetet tek <https://www.euractiv.com/section/enlargement/news/the-brief-macron-pulls-the-balkan-rug>

“Për momentin, veçanërisht me krizën shëndetësore që na ka goditur, ne me të vërtetë jemi në një periudhë kohore ku mendoj se duhet të përdorim pak frenat.”

— Carine, 53, kundërshtuese me interes të madh

“Nëse kriza bëhet edhe më keq, po, nëse përkeqësohet, epo, unë mendoj pse nuk duhet, së pari, ta bashkojmë Evropën kështu siç është tani, me numrin e vendeve që janë aktualisht në Evropë, para se të fillojmë të mirëpresim vendet e tjera? Po, sepse ata thjesht mund të vijnë së bashku me të gjitha problemet e tyre.”

— Cecile, 47, kundërshtues me interes të pakët


Edhe pse kjo ishte një ndjenjë e përgjithshme që lidhej me gjendjen dhe të ardhmen e BE-së në përgjithësi, disa pjesëmarrës gjithashtu shpjeguan se si ky perceptim ndikoi në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë në qëndrimet e tyre në lidhje me zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor.

“Unë e di që ka një diskutim të vazhdueshëm për Ballkanin dhe anëtarësimin e tyre, por nuk besoj në këtë moment do të ishte diçka e mirë për t'i futur ata. Ndoshta pas 10 vjetësh. Por në situatën aktuale me COVID, ne e kemi mjaft të vështirë për të menaxhuar veten, e lëre më të menaxhojmë vendet e tjera që na bashkohen.”

— Valerie, 29, grupi i të pasigurtëve

FIGURA 5

Vlerësimi i zgjerimit të BE në 2004-2007, sipas qëndrimeve ndaj zgjerimit të BE në Ballkanin Perëndimor¹⁶



16 Formulimi i pyetjes: “Nga viti 2004 deri në 2007 dymbëdhjetë anëtarë të rinj u pranuan në Bashkimin Evropian (Bullgaria, Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia). Sipas jush, kjo ishte diçka e mirë apo e keqe për BE-në

Kundërshtuesit ishin të prirur edhe të vlerësonin negativisht raundet e mëparshme të zgjerimit të BE. Shumica dërrmuese e atyre që kundërshtuan anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE ishin gjithashtu të mendimit se shtimi i 12 vendeve në BE midis 2004 dhe 2007 kishte qenë i keq për BE (midis 76 dhe 86% në varësi të interesimit për atë çështje, Figura 5). Kishte një dakordësi të gjerë midis pjesëmarrësve të grupeve të fokusit në grupet e kundërshtimit me nivel të lartë dhe të ulët interesimi që BE-ja funksiononte më mirë - dhe do të funksiononte më mirë edhe në të ardhmen - kur kishte më pak shtete anëtare.

Arsyet për këto pikëpamje negative të raundeve të mëparshme të zgjerimit të BE dhe pranimit të vendeve të tjera në BE janë të ndryshme. Në grupet e fokusit, disa thanë se zgjerimi i BE ishte çuar përpara shumë shpejt dhe se BE u përpoq të integronte shumë aspekte të qeverisjes shumë shpejt, veçanërisht në drejtim të çështjeve ekonomike. Të tjerët mendonin më përgjithësisht se kishte tepër ndryshime midis vendeve anëtare për të qenë në gjendje të krijojnë kohezion në çështjet kulturore, ekonomike dhe strategjike dhe se e gjithë ideja e BE-së do të funksiononte vetëm me më pak vende.

“Unë mendoj se Evropa bëri gjithçka shumë shpejt - Evropën ekonomike, sociale, kulturore, ushtarake - gjithçka menjëherë. Dhe kur i hedh sytë prapa sot - Unë nuk jam vizionar, nuk jam politikan - por mendoj se mbase duhet të kishim pasur Evropë ekonomike para së gjithash me 5, 6, 7, 8 vende që mund të funksiononin ekonomikisht, pastaj Evropa kulturore me 18, një Evropë ushtarake edhe më e madhe. (...) Pse kemi ecur përpara kaq shpejt?”

— Pierre, 65, kundërshtues me interes të pakët

“Ka shumë dallime. Për shembull, sa më shumë vende të jenë, aq më të ndryshëm jemi.”

— Sebastien, 38, kundërshtues me interes të madh

Teksa disa kundërshtues të zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor shprehën mungesë besimi tek përfaqësuesit e zgjedhur në përgjithësi, pranuesit ndiheshin përgjithësisht të përfaqësuar mirë në BE dhe nga politikanët e zgjedhur evropianë.

“Mendoj se tashmë ka shumë shtete anëtare. Nuk dua të jem negativ, por mendoj se është e komplikuar. Sa më shumë vende të jenë, aq më e komplikuar është. Unë mendoj se ka shumë ndryshime dhe boshllëqe midis vendeve të ndryshme (...) Konkretisht, në nivelin e Evropës, ne kemi kaq shumë vende që janë kaq shumë të ndryshme.”

— Thierry, 34, kundërshtuese me interes të pakët

Kjo është tërësisht ndryshe nga mendimet e atyre që janë pro anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Nga ky grup, rreth 80% besonin se raundet e mëparshme të zgjerimit të BE kishin qenë disi ose madje shumë të mira për BE (Figura 5) - pavarësisht se disa pranues thanë se ata vetë kishin shqetësime para zgjerimit. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit të cilët përfaqësuan pranuesit shpjeguan se ata ishin në favor të anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE për shkak të shpresës së tyre se vendet anëtare të reja në BE do ta bënë bashkimin më të fortë në përgjithësi, gjeopolitikisht si dhe ekonomikisht.

“Ne duam forcë ekonomike. Për këtë, duhet të qëndrojmë së bashku.”

— Gerard, 62, grupi i pranuesve

“Një Evropë e bashkuar nuk është e lehtë, por një Evropë e fortë, globale mund të jetë e mirë.”

— Juliette, 29, grupi i pranuesve

“Mendoj se duhet të shohim perspektivën gjeopolitike. Sa më të fortë të jemi, aq më sukses do të kemi kur të përballemi me Kinën, SHBA, etj.”

— Marie-Laure, 44, grupi i pranuesve

Përveç vlerësimeve të përgjithshme të gjendjes së BE-së dhe zgjerimit të saj, qëndrimet në lidhje me perspektivën e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor ishin të lidhura edhe me shkallën sa të përfaqësuar politikisht ndihen njerëzit, dhe specifikisht sa të përfaqësuar ndihen ata si qytetarë në BE. Teksa disa kundërshtues të zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor shprehën mungesë besimi tek përfaqësuesit e zgjedhur në përgjithësi, pranuesit ndiheshin përgjithësisht të përfaqësuar mirë në BE dhe nga politikanët e zgjedhur evropianë.

Midis kundërshtuesve në përgjithësi, por sidomos midis atyre që kishin ndjenja të forta mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor dhe që mendonin se ishte një çështje e spikatur (me rëndësi), kishte një ndjenjë pakënaqësie në lidhje me vendimmarrjen për çështjet evropiane dhe mungesë besimi te përfaqësuesit e zgjedhur. Gjysma e të gjithë kundërshtuesve me interes të pakët dhe 63% e të gjithë kundërshtuesve me interes të madh mendonin se interesat e Francës përfaqësohen dobët në BE (Figura 6) Një pjesë e kësaj mund të jetë për shkak të ndjenjës së mungesës së kontrollit politik mbi vendimmarrjen evropiane, një ndjenjë e shprehur qartë në fokus-grupe:

“Herën e fundit që u mbajt referendum evropian, çfarë ndodhi? Njerëzit votuan jo. Dhe çfarë tha presidenti? Ai tha po. Pra, si mund t’u besojmë përfaqësuesve tanë politikë. Ekziston një krizë e demokracisë evropiane. (...) Ne kemi këtë krizë: na mungon besimi tek autoritetet tona.”

— Monique, 25, kundërshtuese me interes të madh

Në të kundërt, shumica dërrmuese e atyre që pranojnë anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE (midis 75 dhe 83% në varësi të interesimit, Figura 6) dhe gjithashtu një shumicë e atyre që nuk ishin të sigurt për pyetjen mendonin se interesat e Francës ishin të përfaqësuar mirë në BE (45%). Në dallim nga grupet me kundërshtues, ekzistonte një konsensus i qartë midis pranuesve që përfaqësuesve të zgjedhur evropianë mund tu besohet të marrin vendime për çështje komplekse siç është zgjerimi i BE në emër të popullsisë.

“Nuk besojmë se duhet të vendosim ne nëse një vend bashkohet ose jo. Parlamenti përbëhet nga përfaqësues nga vendet tona.”

— Julien, 39, grupi i pranuesve


“Janë këta politikanët evropianë, ata debatojnë mbi ligjet dhe buxhetin, kështu që u takon atyre të vendosin. Ata janë njerëzit që janë shumë më të njohur me këtë temë, ata e dinë se cilat janë subjektet gjeopolitike, ata e dinë se cilat janë sfidat, kështu që unë do të thoja se u takon atyre të vendosin. Kjo është pjesë e rolit të tyre.”

— Luc, 49, Grupi i të pasigurtëve

Në dallim nga grupet me kundërshtues, ekzistonte një konsensus i qartë midis pranuesve që përfaqësuesve të zgjedhur evropianë mund tu besohet të marrin vendime për çështje komplekse siç është zgjerimi i BE në emër të popullsisë.

FIGURA 6**Pikëpamje mbi përfaqësimin e interesave të Francës në BE, sipas qëndrimeve ndaj zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor¹⁷**

Pikëpamjet e përfaqësimit të Francës në BE midis grupeve me qëndrime dhe nivele interesimi të ndryshme për zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor (në %), N=2,025 të anketuar



Teksa qëndrimet e përgjithshme ndaj BE-së dhe shkalla e besimit në procesin politik luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e opinionit francez mbi procesin e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE, disa faktorë të tjerë nuk e bëjnë këtë. Më e rëndësishmja, niveli i njohurive faktike që kishin të anketuarit për vendet në rajon dhe procesin e zgjerimit nuk bëri ndonjë ndryshim në mënyrën se si ata e vlerësuan çështjen. Në përgjithësi, pranuesit,


kundërshtuesit, por edhe ata që thanë se nuk ishin të sigurt për mendimin e tyre ndaj çështjes, të gjithë u përgjigjën në mënyrë të ngjashme në një sërë pyetjesh që testojnë njohuritë faktike të të anketuarve (Figura 7). Kjo është ajo që pritej duke pasur parasysh interesin e pakët për çështjen dhe shkallën në të cilën ndjenjat e heshtura/fshehura dhe ato më të përgjithshme për BE-në dhe zgjerimin e BE-së duket se nxisin qëndrimet.

17 Formulimi i pyetjes: "Sa mirë apo keq mendoni se përfaqësohen interesat e Francës në Bashkimin Evropian?"

FIGURA 7

Njohuri rreth Ballkanit Perëndimor dhe procedurave të zgjerimit sipas qendrimeve ndaj zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor¹⁸

Rezultati mesatar i njohurive të përgjigjeve të sakta në pyetje të llojit e vërtetë / jo e vërtetë, në 15 deklarata, mes grupeve me qëndrime dhe nivele interesi të ndryshme ndaj zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, N=2,025 të anketuar



Në mënyrë të ngjashme, disa nga ndryshimet në qëndrimet ndaj anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE përputhen me faktorët demografikë në popullatën franceze. Gjinia dhe moshë kanë pak ndikim në qëndrimet për këtë çështje, me gratë dhe të rinjtë që prirën të thonë se nuk janë të sigurt për qëndrimin e tyre pak më shpesh sesa burrat. Njerëzit e moshuar kanë disi më shumë gjasa të shprehin një pikëpamje të vendosur mbi pyetjen sesa të rinjtë, më shpesh kundërshtim, ndërsa

të rinjtë ka më shumë të ngjarë të miratojnë. Për më tepër, në dallim nga pyetjet e tjera në lidhje me BE-në, ekziston vetëm një lidhje e vogël midis nivelit të shkollimit dhe qëndrimeve për zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor, me njerëzit që janë pro tij që mesatarisht kanë nivele disi më të larta shkollimi.

Përvoja personale me një ose më shumë vende të Ballkanit Perëndimor ka mundësinë të ndikojë në qëndrimet mbi anëtarësimin e tyre në BE, por


18 Një indeks i përgjigjeve të sakta në pyetje të llojit e vërtetë / jo e vërtetë në fjalitë vijuese: (i) "Një vendim për anëtarësimin në Bashkimin Evropian mund të merret vetëm për të gjitha vendet candidate të Ballkanit Perëndimor së bashku. Vendimet nuk merren për vende të veçanta.", (ii) "Nëse vendet e Ballkanit Perëndimor anëtarësohen në Bashkimin Evropian, kjo do të thotë që Turqia gjithashtu duhet të anëtarësohet automatikisht në Bashkimin Evropian.", (iii) "Edhe nëse Franca voton kundër anëtarësimit të vendeve të reja në Bashkimin Evropian, një shumicë e vendeve të tjera anëtare të BE-së mund të rrëzojnë pozicionin francez në Këshillin Evropian.", (iv) "Popullsia e Malit të Zi, Serbisë, Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës dhe Kosovës së bashku janë afërsisht i njëjti numër me popullsinë e Francës." dhe (v) "Nga vendet e mëposhtme, ju lutemi zgjidhni të gjithë ata që mendoni se janë aktualisht shtete anëtare të Bashkimit Evropian." Kroacia, Gjermania, Irlanda, Norvegjia, Serbia, Sllovakia, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar, Shqipëria, Bosnja, Asnjë nga këto.

nuk është e qartë se sa ndryshim bën për publikun francez në përgjithësi. Pak njerëz në Francë kanë përvojë personale të Ballkanit Perëndimor: vetëm një në dhjetë (10%) kanë udhëtuar ndonjëherë në një vend atje, dhe pak më shumë se një në gjashtë (18%) njohin personalisht dikë nga ai rajon. Të anketuarit të cilët pranonin zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor kishin më shumë të ngjarë të thoshin se ata njihnin dikë nga rajoni (midis 24

dhe 33% të pranuesve, krahasuar me 14 deri në 19% midis kundërshtuesve dhe atyre që nuk janë të sigurt) ose kishin udhëtuar atje (24% mes pranuesve me interes të madh, përkundrajt vetëm 5-9% mes kundërshtuesve dhe atyre që janë të pasigurt, Figura 8), por pjesëmarrësit e grupeve të fokusit kishin të përbashkëta lloje të ndryshme të përvojave personale, pavarësisht nga qëndrimet e tyre ndaj çështjes.

FIGURA 8

Përvojat personale me Ballkanin Perëndimor, sipas qëndrimeve ndaj zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor¹⁹



19 Formulimi i pyetjeve: (i) "A keni udhëtuar ndonjëherë në një nga vendet e mëposhtme: Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut ose Serbi?" dhe (ii) "A njihni personalisht dikë që vjen nga një nga vendet e mëposhtme: Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut ose Serbia?"

3. PRANUESIT DHE KUNDËRSHTUESIT KANË SHQETËSIME TË NJËJTA PËRSA I PËRKET ZGJERIMIT TË BE-SË NË BALLKANIN PERËNDIMOR, POR TRAJTIMIN E TYRE E SHOHIN NË MËNYRA TË NDRYSHME

Kur bëhet fjalë për vlerësime specifike të vendeve në Ballkanin Perëndimor, njerëzit me qëndrime të ndryshme ndaj zgjerimit të BE-së në rajon ndajnë një sërë shqetësimesh. Pjesëmarrësit në studim - pavarësisht qëndrimit dhe rëndësisë që i jepnin - pranuan, për shembull, pabarazitë ekonomike në union, migrimin e mundshëm të fuqisë punëtore dhe ndikimin e saj në ekonominë e Francës, si dhe problemet me stabilitetin demokratik të vendeve në Ballkanin Perëndimor dhe BE në tërësi.

Por pranuesit dhe kundërshtuesit shfaqën qartazi dallime në mënyrën se si i peshuan këto shqetësime dhe i panë ato të trajtuara nga BE-ja në përgjithësi. Në thelb, ata që ishin pro anëtarësimi të Ballkanit Perëndimor në BE besuan se BE mund të përballëte me sfida të tilla, ndërsa ata që ishin kundër ishin më pak optimistë për aftësinë e saj për të integruar vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo ilustron më tej se si qëndrimet ndaj çështjes lidhen kryesisht me vlerësimet e përgjithshme të gjendjes së BE-së, dhe jo aq me stereotipet dhe shqetësimet specifike për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në të gjithë spektrin e mendimeve në Francë, ekziston një ndjenjë që zgjerimi i BE-së në Ballkanin

Perëndimor sjell më shumë përfitim për vendet e rajonit sesa për BE-në dhe anëtarët aktualë të saj. Në të gjitha grupet e fokusit, pavarësisht nga qëndrimet ndaj çështjes, pjesëmarrësit ranë dakord që Shqipëria, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut do të përfitonin më shumë nga anëtarësimi në BE, për sa i përket mundësive të tyre ekonomike, zhvillimit demokratik dhe stabilitetit të përgjithshëm duke patur parasyshtensionet e konfliktet e shkuara, sesa BE-ja nga zgjerimi në rajon.

“Ndoshta ka më shumë përfitim për ata sesa për ne.”

— Elise, 59, grupi i pranuesve

“Do të ishte në interesin e tyre. Unë nuk shoh ndonjë interes për ne.”

— Carine, 53, kundërshtuese me interes të madh

Teksa argumenti se vendet e Ballkanit Perëndimor mund të përfitonin më shumë nga integrimi i tyre në BE sesa vendet anëtare të tanishme ishte një arsye për shqetësim midis kundërshtuesve, për pranuesit ishte një arsye më shumë për të qenë pro. Sipas mendimit të tyre, ishte detyrë e BE-së të mbështeste vendet e Ballkanit Perëndimor dhe shumë ranë

dakord që forcimi i rajonit si një i tërë përfundimisht do të ishte në interes të BE-së. Duke u bazuar në përvojat e kaluara, p.sh. me Portugalinë, pranuesit ishin optimistë për aftësinë e BE-së për të siguruar dhe rritur standardin e jetesës në këto vende. Nga

ana tjetër, kundërshtuesit mendonin se në gjendjen e saj aktuale BE-ja nuk ka kapacitetin për të ndihmuar ndonjë anëtar të ri, sidomos ata që do të kishin nevojë për shumë mbështetje dhe subvencione (Tabela 4).

TABELA 4

Interpretimet e shqetësimeve të pranuesve dhe kundërshtuesve në lidhje me ndikimin ekonomik, zhvillimin demokratik dhe paqen dhe stabilitetin

	PRANUES	KUNDËRSHTUES
Ndikimi ekonomik	<p>“Nëse këto vende do të bashkoheshin me BE, kjo do t’u mundësonte atyre të zhvillohen ekonomikisht.” — Julien, 39, grupi i pranuesve</p> <p>“Unë mendoj se do të ishte një treg i ri ose një grup tregjesh të reja për BE. (...) Ne mund të shkojmë dhe të ndërtojmë në këto vende. Ndërtim, zhvillim dhe gjithashtu krahu i punës; nga një këndvështrim gjeografik, mendoj se do të ishte ideale.” — Christophe, 46, grupi i pranuesve</p>	<p>“Ne do të duhet të subvencionojmë ekonominë e tyre, dhe kështu si rezultat, do të gjendemi në një pozitë ku do të paguajmë më shumë para dhe buxheti ynë tashmë është në vështirësi.” — Fleur, 48, kundërshtuese me interes të pakët</p> <p>“Kur bëhet fjalë për vendet e Ballkanit, një ditë ata mund të kenë një krizë sepse janë të dobët ekonomikisht dhe kështu që, nëse do të kishte një krizë në këto vende, padyshim një nga vendet evropiane që do të duhej t’i ndihmonte ata më së shumti dhe që do të duhej të merrte më shumë borxhe do të ishte Franca.” — Aimee, 18, kundërshtuese me interes të pakët</p>
Migrimi i krahut të punës dhe ndikimi në vendet e punës	<p>“Unë mendoj se konkurrenca është e shëndetshme dhe nëse ata bëhen anëtarë të BE-së, mund të jetë një situatë ku fitohet gjithmonë, në lidhje me shkëmbimet. Po, dakord, gjëja e parë që shohim është krahu i lirë i punës dhe ne trembemi për vendet tona të punës, por gjithsesi kemi inxhinierë që do të udhëtojnë në këto vende për të zhvilluar biznes. Mendoj se në përgjithësi është një situatë përfitimi për të gjithë.” — Julien, 39, grupi i pranuesve</p>	<p>“Dhe shumë prej tyre [qytetarë të vendeve të Ballkanit Perëndimor] do të shpërnguleshin në perëndim. Edhe ky do të ishte problem. Ata tashmë e bëjnë atë në një masë të caktuar. Mendoj se do të ishte edhe më keq.” — Nicolas, 47, kundërshtues me interes të madh</p> <p>“Tjetër frikë që kam është se këto vende kanë një standard më të ulët jetese sesa e jona - kompanitë tona mund të shpërngulen në këto vende, që të mund të përfitojnë nga kostot e ulëta të punës.” — Matthieu, 69, kundërshtues me interes të pakët</p> <p>“Jam e sigurt se disa ndërmarrje do të zhvendosen nëse këto vende anëtarësohen. Disa kompani do të zhvendosen. (...) Shumë francezë janë ndikuar nga anëtarësimi i vendeve të tjera të Evropës Lindore në BE.” — Valerie, 29, grupi i të pasigurtëve</p>

	PRANUES	KUNDËRSHTUES
Zhvillimi demokratik	<p>“Gjithashtu, kjo do të sillte në Evropë një grup shoqërisht pak më pak të qëndrueshme, që shpresojmë se do të bëhen më të qëndrueshme pasi të tjerët janë të qëndrueshëm.”</p> <p>– Elise, 59, grupi i pranuesve</p> <p>“Mund të prodhojë më shumë demokraci dhe të jetë e dobishme për Evropën nëse këto vende shkojnë në drejtimin e duhur.”</p> <p>– Julien, 39, grupi i pranuesve</p>	<p>“Ne do ta ndihmojmë shtetin. (...) Dhe nëse ndihmojmë shtetin, duke ditur korrupsionin që ekziston në vend sot, nuk mendoj se populli do të përfitonte domosdoshmërisht nga ndihma.”</p> <p>– Nicolas, 47, kundërshtues me interes të madh</p> <p>“Ka disavantazhe edhe në këndvështrimin demokratik. Të drejtat e njeriut nuk respektohen gjithmonë dhe këto vende janë në gangrenë nga mafia dhe korrupsioni. (...) Për të ndihmuar institucionet e tyre të funksionojnë, mendoj se do të duhej të paguanim më shumë.”</p> <p>– Fleur, 48, kundërshtues me interes të pakët</p>
Paqja dhe stabiliteti	<p>“Unë jam pro (...) sepse kjo do të siguronte stabilitet në Ballkan. Dhe do të bënte të mundur që Evropa të bëhet një vend më i mirë dhe më i suksesshëm.”</p> <p>– Christophe, 46, grupi i pranuesve</p> <p>“Shumë vende, nëse shikoni historinë e tyre, kanë arritur paqen që kur janë bashkuar me Evropën, dhe kjo është një pikë shumë e mirë. (...) Unë mendoj se mund të jetë e dobishme për ta dhe BE, një premtim për paqe dhe stabilitet.”</p> <p>– Julien, 39, grupi i pranuesve</p>	<p>“Kur flitet për Ballkanin, unë mendoj për tensionin. (...) E shoh si një burim potencial të tensionit. Këto janë vende që gjithmonë janë duke u grindur me njëri-tjetrin dhe nëse për çfarëdo arsye gjërat papritmas plasën, atëherë kthehet në një konflikt të hapur.”</p> <p>– Pierre, 65, kundërshtues me interes të pakët</p>

Si kundërshtuesit me interes të madh, ashtu edhe ata me interes të pakët, si dhe ata që nuk ishin të sigurt për qëndrimet e tyre ndaj zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, kishin të njëjtat shqetësime - veçanërisht në lidhje me pasojat e mundshme ekonomike të zgjerimit për BE-në dhe vendet anëtare të saj. Teksa disa shpresonin që anëtarësimi i Ballkanit Perëndimor mund të rezultojë i dobishëm për tregtinë në BE ose forcimin e monedhës së përbashkët, me përjashtim të pranuesve, shumica dërrmuese e pjesëmarrësve shprehën shqetësime rreth ndikimit të mundshëm të zgjerimit të BE-së në ekonomitë evropiane dhe franceze.

Pjesëmarrësit në grupet e kundërshtuesve dhe të pasigurtët (pavendosurit) shqetësohen për

migracionin e madh të krahut të punës nga Ballkani Perëndimor në Francë, për zhvendosjen e vendeve të punës nga Franca në rajon dhe për ngarkesën në buxhetin e BE-së e më tej të Francës. Sidomos humbja e mundshme e vendeve të punës në Francë ishte një shqetësim i madh dhe shpesh personal,

Ndryshe nga shqetësimet ekonomike, shqetësimet kulturore nuk duket se janë një arsye e rëndësishme për të kundërshtuar integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.

me disa pjesëmarrës që e lidhnin atë drejtpërdrejt me shqetësimet për situatën e tyre financiare. Disa pjesëmarrës gjithashtu lidhën shqetësimet e tyre rreth anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor me përvojat e krizës së fundit të borxhit publik evropian, duke thënë se, ashtu si me Greqinë, shtetet e reja anëtare mund të kenë vështirësi dhe ta detyrojnë Francën të kontribuojë më shumë në buxhetin e BE-së për të financuar subvencione dhe paketa shpëtimi në të ardhmen.

Ndryshe nga shqetësimet ekonomike, shqetësimet kulturore nuk duket se janë një arsye e rëndësishme për të kundërshtuar integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Edhe pse pjesëmarrësit nëpër grupe të ndryshme të fokusit kishin të përbashkët stereotipa të ndryshëm në lidhje me kriminalitetin, nivelin e korrupsionit, kohezionin kulturor dhe tensionet fetare në vendet e Ballkanit Perëndimor, për shumicën e pjesëmarrësve këto duket se luanin pak rol në vlerësimet e tyre për zgjerimin e mundshëm të BE-së në rajon. Vetëm disa nga pjesëmarrësit, dhe vetëm kundërshtues me interesim të madh, i përfshinë këto shqetësime në përgjigjen ndaj pyetjes nëse vendet në Ballkanin Perëndimor duhet të anëtarësohen në BE apo jo.

“Mendoj se ka një nivel masiv korrupsioni. Mendoj se kjo duket mjaft qartë, dhe nuk mendoj se është mirë për vendet fqinje e nuk do të ishte mirë për ne.”

— Nicolas, 47, kundërshtues me interes të madh

Përkundër shqetësimeve të përbashkëta, ka disa avantazhe që njerëzit i pranojnë si përfitime të mundshme, pavarësisht nga qëndrimet e tyre ndaj zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Në të gjithë grupet e fokusit, pjesëmarrësit pranuan

Në të gjithë grupet e fokusit, pjesëmarrësit pranuan se integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE do të sillte përparësi gjeopolitike. Kjo vlen edhe për pjesëmarrësit në grupet e kundërshtuesve: kur ju tregua një hartë e Evropës me vendet anëtare aktuale të theksuara, një numër pjesëmarrësish shprehën habi që vendet e Ballkanit Perëndimor nuk janë ende pjesë e BE-së.

se integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE do të sillte përparësi gjeopolitike (Tabela 5) - sidomos pasi panë pozicionin gjeografik të këtyre vendeve në një hartë përkundrejt shteteve anëtare aktuale. Kjo vlen edhe për pjesëmarrësit në grupet e kundërshtuesve: kur ju tregua një hartë e Evropës me vendet anëtare aktuale të theksuara, një numër pjesëmarrësish shprehën habi që vendet e Ballkanit Perëndimor nuk janë ende pjesë e BE-së.

Pjesëmarrësit shpjeguan se gjeopolitikisht, anëtarësimi në BE mund ta mbrojë rajonin nga ndikimi keqdashës rus, kinez apo edhe i SH.B.A. Për disa, pranimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE do të përbënte madje korrigjim të “një gabimi gjeografik”. Ç’është më e rëndësishmja, kjo pjesë e fundit e argumentit gjeopolitik gjithashtu i ndan vendet e Ballkanit Perëndimor nga vendet e tjera kandidatë, para së gjithash Turqisë.

TABELA 5

Reagimet ndaj një harte të Evropës me vendet aktuale anëtare dhe vendet në Ballkanin Perëndimor të theksuara me ngjyra të ndryshme

GRUPI I PRANUESVE	KUNDËRSHTUESIT – INTERESIM I MADH
<p>“Pozicioni i tyre gjeografik i vendos ata në qendër të Evropës. Ata janë tërësisht anëtarë të Evropës - duhet të jenë.” — Juliette, 29, grupi i pranuesve</p> <p>“Ju nuk doni që rusët t'i kapin ata [Ballkanin Perëndimor], apo jo? Po, asnjëherë nuk i dihet me rusët. Mendoj se është shumë më mirë që ata (BP) të jenë me ne sesa kundër nesh.” — Elise, 59, grupi i pranuesve</p>	<p>“Nëse arsyetojmë nga këndvështrimi gjeografik, është shumë e qartë se ato duhet të jenë pjesë e Evropës.” — Sebastien, 38, kundërshtues me interes të madh</p> <p>“Nga aspekti gjeografik, po absolutisht. Ata janë evropianë.” — Nicolas, 47, kundërshtues me interes të madh</p>
GRUPI I TË PASIGURTËVE	KUNDËRSHTUES – INTERESIM I PAKËT
<p>“Po, kur pranuan Bullgarinë, është logjike të pranojmë edhe ata.” — Yves, 35, grupi i të pasigurtëve</p> <p>“Më shumë kohezion, një entitet më i madh mund të na sjellë më shumë ndikim, të jemi më të fuqishëm, të paktën nëse bota e jashtme na shikon. Pra, nëse Donald Trump mendon të na godasë në kokë ai do të mendohet dy herë para se ta bëjë këtë, sepse kemi një kohezion më të mirë dhe sepse Evropa është më e madhe.” — Francois, 48, grupi i të pasigurtëve</p>	<p>“Po, ata janë në Evropë dhe në këtë rast, më duket mjaft tronditëse që ata nuk janë anëtarë të Bashkimit Evropian kur shikoj këtë hartë specifike.” — Fleur, 48, kundërshtuese me interes të pakët</p>

Argumente të tjerë të dhënë shpesh pro integritetit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE kishin lidhje me pasurimin e mundshëm të jetës kulturore në BE dhe mundësi të reja për udhëtime dhe turizëm. Argumenti i fundit ishte veçanërisht i dukshëm për pjesëmarrësit të cilët përndryshe nuk ishin të sigurt për qëndrimet e tyre ndaj çështjes, sepse lidhej drejtpërdrejt me përvojën e tyre personale përsa i përket vendeve në fjalë.

“Ndoshta këto vende mund të na ofrojnë një vlerë të madhe të shtuar, shumë kulturë, etj.”
— Francois, 48, grupi i të pasigurtëve

“Ndoshta do të ishte [mirë] nga këndvështrimi turistik. Këto janë vende të këndshme. Nëse do të udhëtonim të gjithë në këto vende dhe monedha e tyre do të ishte e njëjtë me tonën, do të ishte një avantazh. Pra, mirë për turizmin.”

— Luc, 49, grupi i të pasigurtëve

Së fundmi, pjesëmarrësit gjithashtu kishin të përbashkët ndjenjën se mungon informacion në lidhje me - dhe në një farë mase, edhe kontrolli mbi procesin e vendimmarrjes në lidhje me zgjerimin e mëtejshëm të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Sidoqoftë, teksa pranuesit binin dakord që ka informacion të mjaftueshëm por, thjesht ata nuk e kishin përdorur, kundërshtuesit dhe ata që nuk ishin

të sigurt për mendimin e tyre mbi këtë çështje, ishin të mendimit se atyre u mungonte informacioni në lidhje me proceset e vendimmarrjes së BE-së (Tabela 6). Për disa pjesëmarrës, kjo mungesë e perceptuar e informacionit shoqërohej me një mungesë kontrolli mbi procesin dhe, në përfundim, me një ndjenjë dorëzimi në lidhje me çështjen.

TABELA 6

Qëndrimet në lidhje me informacionin mbi vendimmarrjen e BE-së në lidhje me zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor

KA INFORMACION MJAFTUESHËM	NUK KA INFORMACION TË MJAFTUESHËM
<p><i>“BE ka bërë shumë përpjekje për të komunikuar. Në qytete ka qendra të informacionit të BE-së ku mund të shkoni dhe të merrni të gjitha llojet e informacioneve. Njerëzit vetë duhet të bëjnë përpjekje, të shkojnë në ato zyra. Ka shumë komunikim edhe midis shteteve, ata përpigën.”</i></p> <p>— Gerard, 62, grupi i pranuesve</p>	<p><i>“Epo, ne nuk dimë, problemi është që ne nuk dimë. Nuk kemi informacione. Ne marrim disa informacione majtas, djathtas dhe qendër që mund t'i shohim në televizion, por kjo është gjithçka që kemi. Epo, kam një përshtypje, por nuk bazohet në ndonjë gjë të prekshme.”</i></p> <p>— Pierre, 65, grupi i kundërshtuesve me interesim të pakët</p> <p><i>“Jo, shumica prej nesh as nuk e di se çfarë po ndodh, pse të na japësh neve fuqitë vendimmarrëse?”</i></p> <p>— Margot, 65, grupi i të pasigurtëve</p> <p><i>“Unë personalisht nuk e kuptoj. Kam përshtypjen se nuk kam kontroll mbi këtë gjë.”</i></p> <p>— Carine, 53, grupi i kundërshtuesve me interesim të madh</p>

4. KOMUNIKIMI PIKË SË PARI DUHET TË TRAJTOJË SHQETËSIMET NË LIDHJE ME BE-NË NË PËRGGJITHËSI

Ky hulumtim ka treguar se si qëndrimet mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor janë mjaft të heshtura. Kjo çështje nuk është e spikatur/ me interes për shumë njerëz në Francë. Pranimi apo kundërshtimi i anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor është më i lidhur ngushtë me vlerësimet e përgjithshme të gjendjes së BE-së, ndjenjat e kontrollit politik dhe në një farë mase me qëndrimet ndaj raundeve të mëparshme të zgjerimit të BE-së, sesa me njohuri faktike mbi Ballkanin Perëndimor ose shqetësime të qarta lidhur me to. Sa shumë dinin njerëzit për rajonin ose procesin e anëtarësimit në BE kishte pak ose aspak ndikim dhe, përveç shqetësimeve mbi pasojat ekonomike, pak shqetësime të qarta për Ballkanin Perëndimor luajtën një rol vendimtar në formësimin e mendimeve të pjesëmarrësve për këtë çështje.

Duke ditur sa shqetësime të heshtura, në vend të njohurive faktike, nxisin qëndrimet në Francë ndaj zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, mundësitë për t'i ndryshuar ato qëndrime janë shumë të pakta. Pa trajtuar shqetësimet më të gjera që kanë njerëzit në lidhje me kohezionin evropian dhe të ardhmen e BE-së, do të jetë e vështirë të bindësh ata që kundërshtojnë zgjerimin e BE-së për shkak të pasojave të tij potencialisht të pafavorshme për BE-në dhe Francën brenda BE-së. Në planin afatgjatë, rruga më e mirë është trajtimi i shqetësimeve në lidhje me të ardhmen e BE (duke filluar me Konferencën e Ardhmërisë së Evropës) dhe sigurimi që komunikimi për zgjerimin e BE në Ballkanin Perëndimor nuk nxit mendime negative mbi kohezionin e Evropës tek votuesit francezë.

Një mënyrë për ta bërë këtë është që komunikimi rreth çështjes të jetë transparent dhe të sigurojë që njerëzit, jo vetëm në Francë, të ndihen të përfshirë gjatë procesit. Kjo mund tu japë siguri kundërshtuesve që kanë shqetësimeve të fshehta, si dhe ata që nuk janë të sigurt në mendimin e tyre për çështjen. Kjo mund të trajtojë edhe mungesën e perceptuar të kontrollit mbi procesin e vendimmarrjes që shprehën disa prej grupeve të fokusit. Informimi i njerëzve mbi procesin e pranimi, kriteret shoqëruese për integrimin në BE dhe sa larg janë vendet e veçanta në proces është shumë i rëndësishëm kur dimë që vazhdojnë diskutimet në lidhje me integrimin e mundshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE dhe kjo është një çështje politike në disa shtete anëtare, jo vetëm në Francë.

Westbalkanregelung i Gjermanisë - legjislacioni që lejon qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor të vijnë në Gjermani për të punuar dhe studiuar - dëshmon se si informimi në lidhje me legjislacionin dhe puna e vazhdueshme me politikën mund të ndikojë në qëndrimet e votuesve në Francë.

Duke ditur sa shqetësime të heshtura, në vend të njohurive faktike, nxisin qëndrimet në Francë ndaj zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, mundësitë për t'i ndryshuar ato qëndrime janë shumë të pakta.

Askush nga pjesëmarrësit në grupin e fokusit nuk dinte për këtë rregullore, por pasi dëgjoi për të, një numër pjesëmarrësish në grupin e pranuesve, të kundërshtuesve me interesim të madh, si dhe në grupin e të pasigurtëve menduan se ajo dërgonte një mesazh interesant që mund të ndryshonte pikëpamjet mbi këtë çështje nëse thjesht më shumë njerëz mësonin për të.

“Epo, unë mendoj që nëse tashmë kemi një vend që u ka hapur kufijtë këtyre vendeve, atëherë do të dukej shumë e arsyeshme të hapnim pjesën tjetër të Evropës ndaj tyre. Me fjalë të tjera, procesi tashmë ka nisur.”

— Juliette, 29, grupi i pranuesve

Një hap tjetër thelbësor drejt krijimit të një imazhi të kohezionit evropian është që kriteret e përcaktuara për procesin e zgjerimit të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjitha vendet candidate – si edhe për vendet e reja dhe vendet anëtare aktuale. Disa pjesëmarrës në studim thanë se nuk kishin informacion mbi progresin që kishin bërë vendet candidate në lidhje me kriteret e përcaktuara në procesin e zgjerimit. Pati gjithashtu një thirrje për më shumë qartësi se si këto kriteret zbatohen për vendet e ndryshme nën diskutim për integrimin në BE, si dhe për vendet anëtare aktuale. Shumë pjesëmarrës e dinin se ekzistonin kriteret specifike për vendet candidate, por shumë pak mund të përmendnin ndonjë kriter.

“Pyetja ime [për Presidentin]: Mbi cilat kriteret dëshironi të mundësoni hyrjen e Ballkanit në BE, dhe si planifikoni të vazhdoni? Kjo është çështja dhe mendoj se kjo është pika kryesore dhe më e rëndësishme për mua. Për të ditur më shumë rreth kësaj, cilat janë kriteret dhe cila do të jetë vlera e shtuar për ne.”

— Francois, 48, grupi i të pasigurtëve

Disa madje iu referuan haptazi faktit që, teksa vendet candidate duhej të arrijnë standarde monitorimi të rrepta, p.sh. për shtetin ligjor dhe nivelin e korrupsionit, vendet anëtare aktuale rregullisht dështojnë në përmbushjen e të njëjtave standarde -

pa ndonjë pasojë të dukshme. Këto shkelje e bëjnë shumë të vështirë për njerëzit që të kenë besim në procesin e zgjerimit dhe të besojnë në respektimin e kriterëve të BE-së nga vendet candidate. Për këtë arsye, disa pjesëmarrës u bënë jehonë thirrjeve për një proces të kthyeshëm të zgjerimit, pra për mundësinë për të përjashtuar vendet e reja anëtare kur nuk përmbushin më kriteret thelbësore për anëtarësimin në BE.

“Besueshmëria e integritetit të ri do të thotë që shtetet që tashmë janë anëtare të BE-së duhet të jenë të qëndrueshme, të menaxhojnë njëri-tjetrin në mënyrë efikase.”

— Margot, 65, grupi i të pasigurtëve

“Greqia u bashkua dhe disa vjet më vonë kuptuam që ata kishin gënjyer, kishin mashtruar me financat (...). Kështu që, unë them le ta shfrytëzojmë këtë përvojë. Nëse e pranojmë Shqipërinë nesër, për shembull, dhe (...) e kuptojmë dhjetë vjet më vonë se ata kanë mashtruar me financat, ne duhet të jemi në gjendje të bëjmë diçka për këtë. (...) Unë mendoj se duhet të jemi të vetëdijshëm për faktin se ato vende që bashkohen, duhet të bashkohen bazuar në kriteret e rrepta dhe, pse jo, të ketë një periudhë prove. Ata mund të pranohen përkohësisht, dhe të shohim se si shkon.”

— Pierre, 65, kundërshtues me interes të pakët

Megjithëse informimi i francezëve mbi kriteret për vendimmarrje në proceset e zgjerimit të BE-së nuk do të kthejë papritur kundërshtuesit në pranues të zjarrtë të anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, ka disa mesazhe që - nëse theksohen - mund të bindin grupe të ndryshme të votuesve francezë. Njëri është argumenti gjeopolitik: që integrimi i Ballkanit Perëndimor në BE do të plotësonte mozaikun evropian, do të forconte proceset demokratike në zemër të Evropës dhe do të mbronte rajonin nga ndikimi i jashtëm keqdashës. Po ashtu, komunikimi mbi kohezionin evropian dhe bazën demokratike të BE-së si një lidhje e kombeve do të vlente për të gjitha tipet e votuesve në Francë, aq sa dhe mesazhet që nxjerrin në pah mundësitë e mundshme për tregti dhe turizëm.

“Pra, nëse krejt papritur, ata [vendet e Ballkanit Perëndimor] nuk mund të bënin çfarë të donin për sa i përket mosrespektimit të të drejtave të njeriut [kjo do të ishte diçka pozitive] – do të ketë një përparim të madh në drejtim të dënimeve me burg në Bashkimin Evropian. Ne jemi shumë të aftë në punën për të drejtat e njeriut.”

— Madeleine, 29, kundërshtuese me interes të madh

“Është mjaft e qartë që ata duhet të përfshihen dhe të krijohet një korridor për turizmin, tregtinë dhe të gjitha llojet e gjërave.”

— Juliette, 29, grupi i pranuesve

Nga ana tjetër, mesazhet e tjera kanë shumë pak mundësi për të bindur grupet e ndryshme. Sipas pjesëmarrësve në grupe fokusi, informacionet që e vënë theksin tek përpjekjet e BE-së për të forcuar vendet në Ballkanin Perëndimor me siguri nuk do të bindin shumë kundërshtues, pasi kundërshtimi i tyre nuk ka të bëjë në të vërtetë me anëtarësimin e vendeve të rajonit në BE. Megjithatë ai është një argument i rëndësishëm dhe bindës për ata që janë pro zgjerimit të BE-së

në rajon, disa kundërshtues thanë se ishin lodhur nga thirrjet për të treguar përgjegjësi morale dhe nga reduktimi i çështjes në ofrimin e mirësisë dhe mbështetjes. Po ashtu, kundërshtuesit janë lodhur edhe me thirrjet për të mbështetur zgjerimin pasi ka potencial për të forcuar monedhën e vetme në BE. Pas përvojës së krizës së borxhit në Greqi, ky argument, më shumë se çdo tjetër, simbolizon tek ata luftën e humbur.

“Epo, ka njerëz që thonë se duhet t’i pranojmë të gjithë. Duhet të jemi të mirë. Duhet ta pranojmë që është në interesin e tyre. Ata do të ndihen më mirë. Do të jetë më mirë për të drejtat e njeriut. (...) Po. Por më ka ardhur në majë të hundës. Ne nuk jetojmë në vendin e arushëve prej pelushi. Pse duhet të jemi të mirë?”

— Monique, 25, kundërshtuese me interes të madh

“Diçka që më bezdis vërtet është kur dëgjoj njerëz të flasin për monedhën e vetme. Ne do të jemi më të fortë falë monedhës së vetme. Duhet ta pranoj, jam lodhur nga kjo.”

— Sebastien, 38, kundërshtues me interes të madh

PËRFUNDIME

Çështja nëse vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të bashkohen ose jo me BE është bërë një debat politik i zakonshëm në Francë. Pozicioni i përkohshëm i qeverisë franceze për të kundërshtuar zgjerimin e mëtejshëm të BE la një shenjë të qëndrueshme në debatet rreth zgjerimit të BE në Francë, si dhe Bashkimin Evropian më gjerë. Deri në ç'masë pasqyrojnë pikëpamjet e popullatës franceze këto diskutime të nivelit të lartë në lidhje me?

Ky studim tregon se shumica e njerëzve në Francë kanë qëndrime mjaft të heshtura ndaj zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Për shumicën, çështja nuk është shumë e spikatur/me interes. Tre në katër persona në Francë besojnë se nuk do të ndikonte shumë, ose aspak, në jetën e tyre nëse Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia hyjnë në BE. Megjithatë kundërshtimi ndaj zgjerimit të mëtejshëm të BE-së është i përhapur në mesin e publikut francez, shumica e kësaj lodhjeje me zgjerimin është rezultat i shqetësimeve më të gjera lidhur me kohezionin evropian, vlerësimet e raundeve të mëparshme të zgjerimit, të ardhmen e BE-së dhe, në një farë mase, rolin e Francës në të.

Për shkak të rëndësisë së paketës të kësaj çështjeje për elektoratin francez, nuk ka gjasa që një vazhdim i procesit të zgjerimit të Ballkanit Perëndimor të ketë një ndikim domethënës në politikën e brendshme franceze në përgjithësi, dhe procesin zgjedhor në veçanti. Frika se qeveria franceze mund të penalizohet nga elektorati për ecjen përpara me zgjerimin nuk gjen bazë në këtë studim. Krahasuar me kundërshtimin disproporcional të të anketuarve ndaj integritimit të Turqisë në BE, çështja e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE është me një interes të pakët. Kjo nuk do të thotë që politikëbërësit nuk duhet të kenë kujdes se mos

Tre në katër persona në Francë besojnë se nuk do të ndikonte shumë, ose aspak, në jetën e tyre nëse Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia hyjnë në BE.

populli ndihet se i kanë hequr të drejta. Përkundrazi, ata duhet të jenë shumë të kujdesshëm për tu siguruar që procesi të mos përkeqësojë ndjenjat e mosbesimit (në BE) dhe mungesën e kontrollit.

Studimi zbulon se pranimi ose kundërshtimi i zgjerimit të Ballkanit Perëndimor në Francë lidhet më ngushtë me vlerësimet e imazhit të BE-së në përgjithësi, ndjenjat e kontrollit politik dhe përfaqësimit në Bashkim dhe raundet e mëparshme të zgjerimit të BE-së, sesa me shqetësime specifike në lidhje me integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Teksa pranuesit dhe kundërshtuesit kanë shqetësime specifike të përbashkëta - psh, në lidhje me ndikimin ekonomik të zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, migrimin e krahut të punës dhe vendet e punës në Francë, si dhe zhvillimin demokratik në rajon dhe paqen dhe stabilitetin në Evropë si një e tërë - ata kanë vlerësime shumë të ndryshme për sa i përket aftësisë së BE-së për të përballuar sfida të tilla.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në grupet e fokusit, përveç atyre me pikëpamjet më të forta kundër, duket se binin dakord se zgjerimi i i BE-së në Ballkanin Perëndimor do të kishte përfitime gjeopolitike, do të kishte kuptim gjeografik, dhe do t'u ofronte evropianëve më shumë mundësi. Nëse,

Për shkak të rëndësisë së pakët të kësaj çështjeje për elektoratin francez, nuk ka gjasa që një vazhdim i procesit të zgjerimit të Ballkanit Perëndimor të ketë një ndikim domethënës në politikën e brendshme franceze në përgjithësi, dhe procesin zgjedhor në veçanti. Frika se qeveria franceze mund të penalizohet nga elektorati për ecjen përpara me zgjerimin nuk gjen bazë në këtë studim.

siç është tani, BE dhe vendet anëtare të saj (përfshirë Francën) vazhdojnë procesin e zgjerimit, ata mund të përmendin këto përfitime të dukshme. Megjithatë, në fund të fundit, strategjia më efektive për të fituar besimin e publikut në procesin e zgjerimit është krijimi i besimit në BE, institucionet e saj dhe rregullat dhe procedurat e saj në përgjithësi. Kjo është padyshim një përpjekje afatgjatë, por në fund të fundit është strategjia më e mirë për ndryshime të qëndrueshme, duke siguruar që procesi i zgjerimit të mos kontribuojë në largimin dhe pakënaqësinë e mëtejshme të votuesve.

Trajtimi i shqetësimeve të tilla është i rëndësishëm, duke parë që po bëhet përparim në negociatat e pranimit, të paktën për disa nga vendet. Disa pengesa të caktuara duhen kapërcyer nga qeveria, por përfshirja e publikut duhet të jetë në interes të aktorëve politikë. Disa diskutues shikuan në mënyrë të favorshme idetë që integrimi i Ballkanit Perëndimor në BE do të plotësonte mozaikun evropian, do të forconte demokracinë në të gjithë

kontinentin dhe do të bënte që Evropa të ishte më e fortë në botë. Sidoqoftë, vetëm ata që i besonin BE-së dhe Francës për të menaxhuar një hap të tillë ishin të kësaj ideje. Për shumë kundërshtues, kundërshtimi i tyre ndaj zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor pasqyron shqetësime të përgjithshme mbi kohezionin evropian dhe mungesën e besimit në BE, institucionet e saj dhe përfaqësuesit e zgjedhur për të realizuar një Evropë të fortë dhe të bashkuar.

Kjo do të thotë se është e nevojshme të fitohet besimi në proces, të rritet besueshmëria e tij. Siç ka treguar ky raport, ka boshllëqe të konsiderueshme njohurish në të gjitha grupet dhe diskutimet zbuluan se disa shqetësime bazoheshin në mungesën e perceptuar të informacionit. Mbajtja e njerëzve të informuar mbi kriteret e pranimit dhe progresin e vendeve në të një mënyrë të ndershme dhe transparente, ka të ngjarë të ndihmojë në krijimin e besimit në proces. Besimi në aftësinë e BE-së për të siguruar standarde të mira, është më i madh kur njerëzit shohin që këto standarde zbatohen edhe në vendet aktuale anëtare nëse lindin probleme. Pra për të arritur ndryshime pozitive duhet parë çështja e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor e lidhur në mënyrë të qartë me debatet rreth funksionimit të BE-së dhe rolit të Francës brenda saj. Përfshirja e popullatës është e mundur, por kërkon një angazhim më ambicioz sesa thjesht të mendosh për ta si "pro" ose "kundër" një çështjeje në një mënyrë të mbyllur dhe të patjetërsueshme.

Besimi në aftësinë e BE-së për të siguruar standarde të mira është më i madh kur njerëzit shohin që këto standarde zbatohen edhe në vendet aktuale anëtare nëse lindin probleme.

SHTOJCA

METODAT

Për këtë projekt, një anketim në internet i krijuar për të intervistuar një grup përfaqësues të njerëzve në Francë rreth perceptimeve të tyre për zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor u pasua nga diskutime të thelluara në fokus-grupe për të mësuar se si pjesë të ndryshme të popullatës përfshihen në diskutime rreth zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Pyetjet që drejtojnë si studimin ashtu edhe grupin e fokusit u formuluan në një seminar një ditë me ekspertë nga një sërë institucionesh evropiane dhe franceze të përfshira në debate mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor.

Sondazhi

Sondazhi përbëhej nga 30 pyetje që përmbledhin gjithsej 42 artikuj të sondazhit. U krijua në mënyrë të atillë që të marrë jo më shumë se 15 minuta nga koha e të anketuarit. Kur ishte e mundur, artikujt e sondazhit u përshtatën nga sondazhe ekzistuese standarde mbi qëndrimet politike (të tilla si Anketa Sociale Evropiane dhe Anketa e Vlerave Evropiane). Sondazhi u programua të kryhej dhe administrohej në internet në bashkëpunim me Bilendi, një kompani franceze sondazhesh. Të anketuarit u rekrutuan përmes panelit të Bilendi dhe ju ofrua stimul në formën e pikëve të shpërblimit të Maximiles. Ata u ftuan të marrin pjesë në sondazh me email dhe u drejtuan në një ndërfaqe në internet që ishte e arritshme dhe e drejtuar drejt smartphone-ve, tabletëve, si dhe kompjuterave desktop. Për të shmangur paragjykimin e vetë-përzgjedhjes, pjesëmarrësit u ftuan të 'bënin një sondazh' ose 'të jepnin mendimin e tyre' dhe në ftesë nuk u përfshinë detaje specifike mbi projektin.

Kampionimi

Të anketuarit u ftuan të marrin pjesë në sondazh midis 9 dhe 25 marsit 2020. Një total prej 4,017 njerëz pranuan ftesën për të marrë pjesë. Në fillim të intervistës, të anketuarit u klasifikuan sipas një kornize të kampionimit. Ato përfshiheshin në kampionin përfundimtar nëse përfundonin të gjithë intervistën dhe kalonin një kontroll të cilësisë së të dhënave. Përgjigjet u kontrolluan për karakteristikat themelore të popullsisë (mosha minimale 18 vjeç, banues në Francën kontinentale, deklarimi i nivelit të arsimit), plotësia dhe lëshimet teknike, shpejtësia dhe refuzimi i vazhdueshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve. 297 të anketuar e braktisën sondazhin në mes të intervistimit dhe 558 intervista të tjera u mbyllën pas kontroleve të cilësisë së të dhënave (shih Tabelën 7).

TABELA 7

Shifrat e përgjigjeve

TREGUESI	VLERA
Numri i të anketuarve në sondazh	4,017
Përfundime të kualifikuara	2,025
Përfundime pjesore	298
Intervista të ndërprera	558
Intervista me kuota të mbiplotësuara	1,136
Shkalla e incidencës	85%
Koha mesatare e plotësimit (në min)	10:44
Mesi i kohës së plotësimit (në min)	7:57

Kuadri i marrjes së mostrave u bazua në kuotat e hollësishme dhe variablat e shtresëzimit që synojnë arritjen e një përfaqësimi të saktë të popullsisë franceze të të rriturve (18 vjeç e lart). Variablat e shtresëzimit përfshinin gjininë, grupmoshat, rajonet dhe nivelet e arsimit. Targetet u zgjedhën bazuar në të dhënat më të fundit nga INSEE dhe Eurostat, duke përfshirë shënjestrat e kryqëzuara të grupeve të moshave dhe rajoneve, si dhe niveleve të arsimit dhe rajoneve. Brenda këtij përcaktimi të objektivave të shtresëzimit, marrja e mostrave ishte e rastësishme nga brenda panelit për përfaqësimin e përafërt në mënyrë domethënëse dhe zvogëlimin e paragjykimëve.

Kur u plotësuan kuotat e pritshme që përfaqësonin karakteristikat e popullsisë, të anketuar të tjerë me ato karakteristika nuk u lejuan të marrin pjesë në studim. Nga 9-18 marsi 2020, të gjithë anëtarët e ftuar për të marrë pjesë ishin përfshirë në mostër nga aspekti natyror (43 përqind e të gjitha intervistave të plota). Pjesa e mbetur e kampionit u mbush me të anketuar të shpërndarë në kuota specifike të shtresimit. Për të shmangur një përfaqësim të tepruar të grupeve të caktuara, një total prej 1,136 intervistash (28 përqind e të gjithë të anketuarve të kampionuar) u filluan, por u mbyllën në periudhën nga 18-25 mars 2020 për mos përmbushje të objektivave të shtresimit (shih Tabelën 7).

TABELA 8

Pajisjet e përdorura për aksesimin e sondazhit, në të gjitha intervistat e përfunduara

PAJISJA	NUMRI	PËRQINDJA
PC/laptop/netbook	1224	60%
Tablet	86	5%
Smartphone	715	35%
TOTALI	2025	100%

Të anketuarit mund të zgjidhnin se cilën pajisje me lidhje interneti donin të përdornin për t'iu përgjigjur pyetjeve. Shumica e të anketuarve iu përgjigjën sondazhit në një PC ose laptop. Një total prej 35 përqind e të anketuarve zgjedhën t'iu përgjigjen sondazhit në një pajisje të lëvizshme siç është një tabletë ose smartphone (shih Tabelën 8). Të anketuarit mund ta fillonin, ta ndërprisnin dhe ta vazhdonin sondazhin sipas dëshirës.

Përfaqësueshmëria e kampionit

Tabela 9 ilustron përbërjen e kampionit sipas treguesve socio-demografikë dhe gjeografisë, krahasuar me të dhënat më të fundit në dispozicion nga INSEE dhe Eurostat. Përfaqësueshmëria e kampionit u vlerësua bazuar në gjini²⁰, moshë²¹, rajon²², dhe arsimim²³. Grupi i të anketuarve përputhet shumë me popullsinë e rritur franceze, me vetëm një mbi-përfaqësim shumë të vogël të grave, grupmoshës 55-64 vjeç dhe atyre me arsim të lartë. Gjithashtu, në vlerësuar preferencat politike të të anketuarve përkundrejt sondazhit të fundit të përgjithshëm në dispozicion mbi preferencat e partive politike, të kryer nga Elabe për BFMTV në shkurt 2020.²⁴

20 "Jeni?" Mashkull/Femër

21 "Sa vjeç jeni?" 18-24, 25-34, 35-44, 45-54, 55-64 dhe 65+ vjeç

22 "Në cilin rajon jetoni?" Shih listën e rajoneve në Tabelën 3

23 "Ju lutemi zgjidhni nivelin më të lartë të arsimit që keni përfunduar." Kodifikuar në Më pak sesa arsimit fillor, fillor dhe të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe pas-të mesëm arsim jo-të lartë dhe arsim të lartë

24 "Pa menduar vetëm për zgjedhjet, me cilën parti apo lëvizje politike ndiheni më afër?" Shihni listën e partive në Tabelën 3, sipas sondazhit të BFMTV / Elabe.

TABELA 9

Kampion pa koefiçent dhe me koefiçent për Francën (N=2,025) krahasuar me synimet (në %)

	SYNIMI*	KAMPION PA KOEFIÇENT	DIFERENCA	KAMPION ME KOEFIÇENT	DIFERENCA
Mashkull	48	47	-1	48	0
Femër	52	53	+1	52	0
18-24 vjeç	10	9	-1	10	0
25-34 vjeç	15	15	0	15	0
35-44 vjeç	16	16	0	16	0
45-54 vjeç	17	17	0	17	0
55-64 vjeç	16	17	+1	16	0
65+ vjeç	26	26	0	26	0
Auvergne-Rhône-Alpes	12	12	0	12	0
Bourgogne-Franche-Comté	4	4	0	4	0
Bretagne	5	5	0	5	0
Centre-Val de Loire	4	4	0	4	0
Corse	1	1	0	1	0
Grand Est	9	8	0	9	0
Hauts-de-France	9	9	0	9	0
Ile de France	19	19	0	19	0
Normandie	5	5	0	5	0
Nouvelle-Aquitaine	9	9	0	9	0
Occitanie	9	9	0	9	0
Pays de Loire	6	6	0	6	0
Provence-Alpes-Côte d'Azur	8	8	0	8	0
Më pak se arsimit fillor, fillor dhe i mesëm i ulët*	21	20	-1	21	0
Arsimi i mesëm i lartë dhe pas-mesëm jo-i lartë*	43	43	0	43	0
Arsimi i lartë*	37	38	+1	37	0
DLF - Debout la France	2	1	-1	1	-1
EELV - Europe Écologie - Les Verts	8	8	0	8	0
Génération.s	1	1	0	1	0
FI - La France Insoumise	6	6	0	6	0
LO - Lutte Ouvrière	1	1	0	1	0
LR - Les Républicains	9	8	-1	8	-1

	SYNIMI*	KAMPION PA KOEFIÇENT	DIFERENCA	KAMPION ME KOEFIÇENT	DIFERENCA
LREM - La République En Marche	9	13	+4	13	+4
MoDem - Le Mouvement démocrate	2	3	-1	3	+1
NPA - Le Nouveau parti anticapitaliste	1	1	0	1	0
PC - Le Parti communiste	1	1	0	1	0
PS - Le Parti socialiste	5	8	+3	8	+3
RN - Le Rassemblement National	12	12	0	12	0
UDI - Union des démocrates et indépendants	1	1	0	1	0
Tjetër parti apo lëvizje politike	1	1	0	1	0
Pa preferenca partish politike	36	29	-7	29	-7

* Gjinia, mosha, rajoni bazuar në të dhënat e fundit nga INSEE 2020, arsimit i bazuar në Eurostat 2019, preferencat e partive politike bazuar në sondazhin BMFTV / Elabe Shtator 2019 (duke përfshirë 'Preferoj të mos përgjigjem')

Vlen të përmendet se analizat për këtë projekt janë më përfaqësuese të votuesve ose njerëzve me preferencë për një parti politike sesa të jo-votuesve. Kjo është e zakonshme në hulumtimet e sondazheve politike dhe nuk ndikon në rezultatet krahasuar me hulumtimet e tjera të sondazhit. Janë kryer kontrolle të ndjeshmërisë në të cilat ne i kemi dhënë koeficient kampionit për preferencën e partisë së raportuar, në mënyrë që të përputhet me shpërndarjen e raportuar nga sondazhi i Elabe / BFMTV, përveç koeficientëve demografikë të aplikuar (shih detajet mbi procedurën e koeficientit më poshtë). Koeficienti sipas preferencës së partisë politike ndryshoi vetëm pak rezultatet e përgjithshme të sondazhit; Rezultatet thelbësore me implikime për krahasimin nuk kanë ndryshuar. Detajet e këtyre analizave mund të vihen në dispozicion nëse kërkohen.

Koeficienti shtesë

Mostra paraqiti një mbi-përfaqësim të vogël të femrave, personave të moshës 55-64 vjeç dhe të diplomuarve. Për të kompensuar këtë dhe për të siguruar që rezultatet të jenë përfaqësuese të popullsisë kombëtare për sa i përket demografisë dhe gjeografisë, u përdor një koeficient shtesë. Duke

shënjestruar ndarjen përfaqësuese kombëtare në gjini, rajon, grupmoshë dhe arsim bazuar në të dhënat më të fundit të INSEE dhe Eurostat, koeficientët u krijuan duke përdorur përshtatje proporcionale të njëkohshme përsëritëse.

Me këtë proces, krijohet një koeficient individual për secilin të anketuar. Të marra së bashku këto koeficientë individualë rregullojnë kampionin total në mënyrë të tillë që variablat e zgjedhur demografikë të përputhen me vlerat aktuale të njohura në popullatë në të njëjtën kohë. Koeficientët u krijuan të tilla që vlerat individuale nuk kaluan një koeficient minimal prej 0.8 dhe një koeficient maksimal prej 1.25 për të anketuarit. Devijimi standard i të gjithë koeficientëve ishte vendosur të mos kalonte 0.1.

Kur zbatohen këto koeficientë specifikë të të anketuarve në kampionin me koeficient, mbi-përfaqësimi i vogël në aspektin e gjinisë, moshës dhe arsimit çrrënjohet. U kryen testet e ndjeshmërisë në mostrën përfundimtare me koeficient në krahasim me atë pa koeficient dhe u zbuluan vetëm ndryshime të vogla midis gjetjeve të paraqitura në raport (me koeficient) dhe rezultateve pa koeficient.

Grupet e fokusit

Bazuar në rezultatet e anketimit, diskutimet në grupet e fokusit u krijuan për të mësuar se si njerëzit që mbajnë qëndrimet më të ndryshme të identifikuar në popullatë përfshihen në diskutime rreth zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Grupet përfaqësuan qëndrimet e mëposhtme:

- (i) Kundërshtues me interes të madh (ata që ishin kundër zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor dhe e konsideronin atë si një çështje të përparësisë më të lartë)
- (ii) Kundërshtues me interes të pakët (ata që ishin kundër zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, por për të cilët nuk ishte një çështje me shumë interes)
- (iii) Pranuesit (këtu futen edhe ata që e shikonin zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor si një çështje me interes të madh, si dhe ata për të cilët ishte një çështje me përparësi të ulët ose që nuk ishin të sigurt se si ndiheshin për rëndësinë e çështjes)
- (iv) Pjesëmarrësit të cilët nuk ishin të sigurt se çfarë mendonin për zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor, pavarësisht se sa e rëndësishme mendonin se ishte çështja

Pjesëmarrësit u rekrutuan me telefon në dhe përreth qytetit të Lionit në Francë, dhe u renditën në një nga katër grupet sipas përgjigjeve të pyetjeve të sondazhit që përcaktonin qëndrimet dhe vlerësimet e rëndësishme të zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor. U zgjodh Lioni për të gjitha grupet e fokusit për të siguruar krahasueshmërinë ndërmjet grupeve dhe për shkak se ka një popullsi të larmishme, si urbane ashtu edhe rurale.

Grupet e fokusit u mbajtën në 23 dhe 24 shtator 2020 (shtyrë fillimisht nga 14 dhe 15 maji 2020 për shkak të kufizimeve të koronavirusit). Diskutimet e grupeve të fokusit u krijuan për të mbledhur mendimet dhe vlerësimet e pjesëmarrësve për (a) zgjerimin e BE-së dhe BE në përgjithësi, (b) pikëpamjet e tyre për Ballkanin Perëndimor në përgjithësi si dhe zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor në mënyrë specifike. Pjesëmarrësit u kërkuan më tej (c) të mendojnë për zgjerimin e BE në mënyra të veçanta (p.sh. përmes një këndvështrimi ekonomik ose humanitar) dhe (d) u testuan lloje të ndryshme skenarësh dhe mesazhesh në lidhje me zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor.

Gjithsej morën pjesë 28 persona në katër diskutime në fokus grupe, me shtatë pjesëmarrës të pranishëm në secilin grup. Diskutimet zgjatën nga 1 orë e 45 minuta deri në 2 orë secili. Tabela 10 ofron një përmbledhje të pjesëmarrësve, grupeve dhe karakteristikave kryesore. Pjesëmarrësve u janë dhënë pseudonime që pasqyrojnë gjininë e tyre.

Pjesëmarrësit në grupet e fokusit ishin midis 18 dhe 69 vjeç, me një moshë mesatare prej 47 vjeç në të gjitha grupet, me përjashtim të grupit (i) kundërshtues me interes të madh, pjesëmarrësit e të cilit ishin mesatarisht pak më të rinj (38 vjeç mesatarisht). Pjesëmarrësit përfaqësonin një sërë profesioneve si mësues, administratorë shkolle, infermierë dhe punonjës spitali, elektrikistë, avokatë, dizenjues dhe inxhinierë. Një pjesëmarrës ishte student në universitet, një ishte në pension dhe një i papunë. Ata jetonin brenda në qytet, në periferi dhe në mjedise më rurale jashtë Lionit, dhe kishin nivele të ndryshme të arsimit, duke filluar nga asnjë arsim, deri tek niveli pasuniversitar dhe profesional (BAC +5). Pjesëmarrësit thanë se ndiheshin afër me një sërë partish politike (EELV, LREM, LR, DLF, PS, UDI), pa ndonjë model specifik për asnjë nga grupet, dhe katër pjesëmarrës thanë se nuk ndiheshin të afërt me asnjë parti politike.

TABELA 10

Pamje e përgjithshme dhe karakteristikat kryesore të pjesëmarrësve në grupet e fokusit

#	Grupi	Alias	Gjinia	Mosha	Pozicioni i punës	Zgjerimi i BE-së në ballkanin perëndimor do të ishte	Ndikimi i zgjerimit të BE të ballkanit perëndimor në jetën e tyre
1	Kundërshtues, interes i madh	Monique	Female	25	Mësuese	Shumë keq	Një farë ndikimi
2	Kundërshtues, interes i madh	Madeleine	Female	29	Avokat	Disi keq	Një farë ndikimi
3	Kundërshtues, interes i madh	Guillaume	Mashkull	31	Roje shkolle	Disi keq	Ndikim i madh
4	Kundërshtues, interes i madh	Sebastien	Mashkull	38	Punonjes banke	Disi keq	Një farë ndikimi
5	Kundërshtues, interes i madh	Etienne	Mashkull	40	Menaxher i kontabilitetit	Shumë keq	Një farë ndikimi
6	Kundërshtues, interes i madh	Nicolas	Mashkull	47	Menaxher shitjesh	Shumë keq	Një farë ndikimi
7	Kundërshtues, interes i madh	Carine	Femër	53	Dizanjuese tekstilësh	Disi keq	Një farë ndikimi
8	Kundërshtues, interes i pakët	Aimee	Femër	18	Studente	Disi keq	Aspak ndikim
9	Kundërshtues, interes i pakët	Thierry	Mashkull	34	Menaxher sigurimesh	Disi keq	Pak ndikim
10	Kundërshtues, interes i pakët	Cecile	Femër	47	Asistente shkolle	Disi keq	Nuk e di
11	Kundërshtues, interes i pakët	Fleur	Femër	48	Eksperte ligjore	Disi keq	Pak ndikim
12	Kundërshtues, interes i pakët	Eleonore	Femër	59	Operatore	Disi keq	Pak ndikim
13	Kundërshtues, interes i pakët	Pierre	Mashkull	65	Konsulent Burimesh Njerëzore	Disi keq	Pak ndikim
14	Kundërshtues, interes i pakët	Matthieu	Mashkull	69	Pensionist	Disi keq	Pak ndikim
15	Pranues, interes i madh + i pakët	Juliette	Femër	29	Kordinatorë qendre argëtimit	Disi mirë	Pak ndikim
16	Pranues, interes i madh + i pakët	Julien	Mashkull	39	Menaxher	Disi mirë	Pak ndikim
17	Pranues, interes i madh + i pakët	Marie-Laure	Femër	44	Zbatues teknik	Disi mirë	Pak ndikim
18	Pranues, interes i madh + i pakët	Christophe	Mashkull	46	Konsulent pronash	Disi mirë	Aspak ndikim
19	Pranues, interes i madh + i pakët	Adel	Mashkull	50	Elektriçist	Disi mirë	Pak ndikim
20	Pranues, interes i madh + i pakët	Elise	Femër	59	Punonjëse spitali	Disi mirë	Pak ndikim
21	Pranues, interes i madh + i pakët	Gerard	Mashkull	62	Konsulent	Shumë mirë	Pak ndikim
22	Grupi i të pasigurtëve	Valerie	Femër	29	Graphic designer	Nuk e di	Nuk e di
23	Grupi i të pasigurtëve	Yves	Mashkull	35	Menaxher furre pjekjeje	Nuk e di	Nuk e di
24	Grupi i të pasigurtëve	Dominique	Femër	46	Mësuese shkolle	Nuk e di	Nuk e di
25	Grupi i të pasigurtëve	Francois	Mashkull	48	Shitës	Nuk e di	Nuk e di
26	Grupi i të pasigurtëve	Luc	Mashkull	49	Inxhinier IT	Nuk e di	Nuk e di
27	Grupi i të pasigurtëve	Agnes	Femër	56	Punonjëse mjekësore/psikologjie	Nuk e di	Nuk e di
28	Grupi i të pasigurtëve	Margot	Femër	65	Menaxhere shitjesh	Nuk e di	Nuk e di

Diskutimet në grupet e fokusit u regjistruan me video, u përkthyen në anglisht dhe u transkriptuan plotësisht. Transkriptet u analizuan në mënyrë tematike sipas pyetjeve të renditura (a-d) dhe u bënë krahasime ndërmjet grupeve për të gjitha pyetjet kryesore. Citimet në këtë raport mbështeten në përkthimet nga autorët dhe përfaqësojnë

zgjedhjen e fjalëve të pjesëmarrësve sa më afër që të jetë e mundur. Citimet janë shënuar me shkronja të pjerrëta, shtesat editoriale për kontekstin përcaktohen në kllapa katrore [...], dhe fshirjet për të shkurtuar citimin origjinal janë shënuar me (...) në të gjithë këtë raport.

**OPEN SOCIETY
EUROPEAN POLICY
INSTITUTE**

